

MEKANIZMI I SHQYRTIMIT TË KËRKESAVE NË MASË PËR TË DREJTAT PRONËSORE: Përvoja e Kosovës

Qershor 2020



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Kosovë

**MEKANIZMI I
SHQYRTIMIT TË
KËRKESAVE NË
MASË PËR TË
DREJTAT
PRONËSORE:**

Përvoja e Kosovës

Qershor 2020

PASQYRA E PËRMBAJTJES

LISTA E SHKURTESAVE.....	2
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1. HYRJE	5
1.1 <i>Themelimi i mekanizmave të shqyrtimit të kërkesave në masë.....</i>	5
1.2 <i>Fushëveprimi i raportit.....</i>	9
1.3 <i>Metodologjia.....</i>	10
2.KORNIZA LIGJORE DHE AJO E POLITIKAVE NDËRKOMBËTARE DHE VENDORE..	11
3. ANALIZË E SITUATËS.....	13
3.1 <i>Uzurpimi dhe dëbimi</i>	13
3.2 <i>Njoftimi fizik i pronave</i>	18
3.3 <i>Skema e administrimit/qiradhënies</i>	20
3.4 <i>Rrënimi</i>	23
3.5 <i>Shqyrtimi paralel i rasteve nga gjykatat</i>	26
3.6 <i>Kërkesat e kategorisë A dhe C</i>	27
3.7 <i>Sfidat e lidhura me financat dhe personelin</i>	30
4. PËRFUNDIM.....	34

LISTA E SHKURTESAVE

AKK	Agjencia Kadastrale e Kosovës
AKKVP	Agjencia Kosovare e Krahasimit dhe Verifikimit të Pronave
AKP	Agjencia Kosovare e Pronës
APKB	Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara
BE	Bashkimi Evropian
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas
DÇPB	Drejtoria për Çështje Pronësore dhe Banesore
HRW	Human Rights Watch
DP	Deputet i Parlamentit
DUDNJ	Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
GJEDNJ	Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut
IAP	Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës
ICERD	Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor
IPVQ	Institucionet e Përkohshme të Vetë-Qeverisjes
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KKKP	Komisioni i Kosovës për Kërkesa Pronësore
KKP	Komisioni për Kërkesa Pronësore
KKPB	Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore
KPK	Kodi Penal i Kosovës
KVVP	Komisioni për Verifikim dhe Vendosije të Pronave
MM	Memorandum Mirëkuptimi
MSA	Marrëveshja për Stabilizim-Asocim
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PK	Policia e Kosovës
PSBE	Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian në Kosovë
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara
PZH	Person i zhvendosur
RKSKB	Rezolutë e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara
UNHCR	Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët
UNSCR	Misioni i Kombeve të Bashkuara për Administratë të Përkohshme në Kosovë

1. HYRJE

Për shkak të konflikteve, luftërave e trazirave, çdo vit, miliona njerëz detyrohen të ikin për të shpëtuar, duke lënë prapa shtëpitë, tokat e pronat e tyre. Raporti vjetor i UNHCR-së Trendet Globale tregon që në vitin 2018, në gjithë botën mesatarisht një person është zhvendosur çdo dy sekonda. Kjo nënkupton mbi 70 milionë njerëz, ku vendet në zhvillim janë më të prekurat.³

Ndonëse konflikti në Kosovë ka përfunduar para dy dekadash, shumë konteste pronësore mbeten të pazgjidhura edhe sot e kësaj dite. Kjo ndikon në masë të madhe në të drejtat e njeriut të të gjitha komuniteteve, sidomos të atyre që jetojnë të zhvendosur. Në fakt, mbrojtja e pamjaftueshme e të drejtave pronësore të personave të zhvendosur mbetet njëra prej pengesave kryesore në procesin e tyre të kthimit. Prandaj, autoritetet përgjegjëse duhet të bëjnë hapa kuptimplotë për të siguruar që të drejtat pronësore të mbrohen në atë mënyrë që është e favorshme për kthimin.⁴

Adresimi i çështjes së kërkesave të pazgjidhura pronësore të lidhura me konfliktin është parakusht i domosdoshëm për arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të secilës shoqëri të pasluftës, duke përfshirë Kosovën, që është arsyeja pse Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) vazhdon t'i kushtojë rëndësi parësore kësaj teme. Sigurimi i mjeteve juridike për këto kategori specifike të kërkesave pronësore kontribuon jo vetëm në mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të njeriut tek palët e prekura, por ndikon edhe në procesin e pajtimit brenda shoqërisë.

Andaj, si vazhdim i raportit të vitit 2011 "Sfidat në zgjidhjen e kërkesave pronësore të lidhura me konfliktin në Kosovë"⁵, ky raport analizon sfidat me të cilat përballen Drejtoria për Çështje Pronësore dhe Banesore (DÇPB), Agjencia Kosovare e Pronës (AKP), si dhe Agjencia aktuale e Kosovës për Krahasimin dhe Verifikimin e Pronave të Kosovës (AKKVP) në përpjekjet e tyre, rezultatet që i kanë arritur dhe boshllëqet që kanë mbetur.

1.1 Themelimi i mekanizmave të shqyrtimit të kërkesave në masë

Sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB nga viti 1999, Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) iu dha

³ Raporti i Trendeve Globale UNHCR, Zhvendosja e detyruar më 2018, 19 qershor 2019, f. 2. Gjetet tek https://reliefweb.int/sites/reliefweb.int/files/resources/5d08d7ee7_0.pdf, qasur më 24 qershor 2019.

⁴ Zyra Rajonale e UNHCR-së në Evropën Juglindore, Personat e zhvendosur nga Kosova në rajon - Rivlerësim i interesimit për t'u kthyer, 2017, f. 12. Gjetet tek https://www.unhcr.org/see/wp-content/uploads/sites/57/2018/11/UNHCR_KOS_Needs-Assessment-Report_NA_English-1.pdf, qasur më 24 qershor 2019.

⁵ Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë, Sfidat në zgjidhjen e kërkesave pronësore të lidhura me konfliktin në Kosovë, qershor 2011. Gjetet tek <https://www.osce.org/kosovo/80435?download=true>, qasur më 1 July 2019.

përgjegjësia për të siguruar "kthimin e papenguar të të gjithë refugjatëve dhe personave të zhvendosur në shtëpitë e tyre në Kosovë"⁶ derisa institucionet vendore të jenë në gjendje që të marrin përsipër një përgjegjësi të tillë. Prandaj, për të adresuar çështjen e kontesteve të pazgjidhura pronësore në lidhje me humbjen e pronave banesore, si pasojë e konfliktit dhe legjislacionit diskriminues, në nëntor të vitit 1999 me Rregulloren e UNMIK-ut 1999/23, u krijua DÇPB-ja dhe Komisioni për Kërkesat Pronësore dhe Banesore (KKPB).⁷

Derisa DÇPB-ja ishte ngarkuar me menaxhimin e përgjithshëm administrativ të kërkesave të paraqitura, ⁸KKPB-ja, ishte mandatuar si organ kuazi gjyqësor, me të drejtën për të zgjidhur kontestet private jo-komerciale lidhur me pronat banesore. Vendimet e KKPB-së për kërkesat ishin të plotfuqishme dhe të ekzekutueshme dhe nuk i nënshtroheshin shqyrtimit nga ndonjë autoritet tjetër gjyqësor ose administrativ në Kosovë.⁹ Me zgjidhjen e 28,716 kërkesave për prona banesore (që arrin në përqindjen prej 98.75 të numrit të përgjithshëm të kërkesave) përkundër gjitha pengesave, ky mekanizëm përgjithësisht arriti të përmbushë mandatin e tij.¹⁰

KKPB-ja ka ushtruar kompetencë ekskluzive në tre lloje të kërkesave për prona banesore:

1. Kërkesat e kategorisë A (diskriminimi): kërkesa të paraqitura nga individë që kanë humbur të drejtat e tyre të pronësisë, posedimit ose banimit mbi pronën e paluajtshme banesore¹¹ pas datës 23 mars 1989¹², sipas legjislacionit i cili u konstatua se ishte diskriminues, qoftë në zbatimin apo qëllimin e tij.¹³

⁶ Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, S/RES/1244, 10 qershor 1999. Gjetet në https://peacemaker.un.org/sites/peacemaker.un.org/files/990610_SCR1244%281999%29.pdf, e qasur më 20 nëntor 2019.

⁷ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/23 për themelimin e Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore si dhe Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore, 15 nëntor 1999 (Rregullorja nr. 1999/23).

⁸ Pranimi dhe procedimi i kërkesave, si dhe zbatimi i vendimeve të KKPB-së.

⁹ Megjithatë, Rregullorja e UNMIK-ut 2000/60 përmbante procedurë rishikimi, që i mundësonte palës kërkuese apo cilësdo palë me interes që të parashtronte kërkesë për rishikim të ndonjë vendimi. Për më shumë informata, shih nenin 2.7 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23, si dhe nenin 14 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

¹⁰ Rreth 5,080 palë zgjodhën riposedimin e pronave të tyre, ndërsa 3,419 palë kanë kërkuar që DÇPB-ja të vinte pronat e tyre nën administrimin e saj. 2,207 të tjerë kanë kërkuar përmbylljen e kërkesave të tyre me marrjen e vendimit të KKPB-së për ta. Për detaje të mëtejshme, shihni Raportin Përfundimtar 2007, Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore, Kapitulli 8 (Dorëzimi dhe Zbatimi i Vendimeve të KKPB-së), Statistikat e Zbatimit, f. 72. Gjetet në http://www.kpaonline.org/hpd/pdf/HPCC-Final_Report.pdf, qasur më 28 mars 2019.

¹¹ Të drejtat pronësore në lidhje me kërkesat e Kategorisë A i referohen banesave në pronësi shoqërore. Për shkak të legjislacionit diskriminues të vendosur nga autoritetet mes 23 marsit 1989 dhe 24 marsit 1999, shumë shqiptarë u përjashtuan nga puna, duke humbur kështu të drejtat e banimit mbi pronat e tyre. Kjo ka ndodhur për shkak të faktit që të drejtat e banimit kanë qenë të lidhura me punësimin. Si pasojë, ishin titullarët serbë të të drejtave të banimit që kryesisht ishin në gjendje të konvertonin të drejtat e tyre të banimit në të drejta pronësore, duke blerë banesat nga titullarët e të drejtave të ndarjes së banesave, sipas procesit të standardizuar të privatizimit, të vendosur në atë periudhë kohore. Diskriminimi i së drejtës pronësore është përcaktuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/23, neni 1, paragrafi 1.2 (a), 15 nëntor 1999. Gjetet në <http://www.kpaonline.org/frameworkPDFs/01RE1999-23.pdf>, e qasur më 19 mars 2020.

¹² Më 23 mars 1989, Kuvendi i Kosovës votoi ndryshimet kushtetuese, që u aprovuan më vonë edhe nga Kuvendi i Serbisë, lidhur me autonominë, siç parashihej me Kushtetutën e Jugosllavisë të vitit 1974.

¹³ Roli fillestar i KKPB-së ishte të kuptonte nëse të drejtat e lartpërmendura të kërkuësve ishin të vlefshme në atë kohë, si dhe nëse po, nëse ato të drejta ishin revokuar si pasojë e zbatimit të masave diskriminuese. Për më shumë detaje, shih Raportin Përfundimtar 2007, Komisioni për Kërkesat Pronësore dhe Banesore, Kapitulli 2, faqe 18-20. Gjetet në <https://pca-cpa.org/wp-content/uploads/sites/175/2016/01/HPCC-Final-Report-2007.pdf>, e qasur më 25 korrik 2018.

2. Kërkesat e kategorisë B (transaksionet joformale): kërkesa të parashtruara nga individë të cilët, në ngjarjet pas datës 23 mars 1989, bënë transaksione joformale të pasurive të paluajtshme pronësore në bazë të vullnetit të lirë të palëve.¹⁴
3. Kërkesat e kategorisë C (uzurpim i paligjshëm): kërkesa të paraqitura nga individë që kishin ushtruar të drejtat e pronësisë, posedimit ose banimit para datës 24 mars 1999¹⁵, si dhe të cilët për shkak të uzurpimit të paligjshëm të pronave të tyre kishin pushuar të gëzonin të drejtat e tilla.¹⁶ Kjo përbënte afërsisht 93 për qind¹⁷ të numrit të përgjithshëm të kërkesave të pranuar nga pronarët që ishin privuar nga të drejtat e tyre pronësore.

Pasi kuptoi që kishte edhe një numër të konsiderueshëm kontestesh për pronat bujqësore dhe komerciale që nuk ishin trajtuar në kuadër të DÇPB-së,¹⁸ përpjekjet e bashkësisë ndërkombëtare për zgjidhjen e këtyre kontesteve pronësore filluan në fazën vijuese. UNMIK-u themeloi AKP-në në vitin 2006, e cila, përveç kërkesave lidhur me pronat banesore ishte mandatuar edhe me pranimin, regjistrimin dhe asistimin e gjykatave në trajtimin e kërkesave që lidheshin me pronat bujqësore dhe komerciale.¹⁹ AKP-ja zëvendësoi DÇPB-në dhe ruajti praninë e saj në terren²⁰ dhe strukturën organizative,²¹ ndërsa vendimet e Komisionit të Kosovës për Kërkesa Pronësore²² (KKKP) do t'i nënshtroheshin shqyrtimit vetëm nga Kolegji i Apelit i Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me AKP-në dhe jo nga gjykatat e rregullta.²³

¹⁴ KKPB-ja synonte të përcaktonte titullin e saktë të palëve që hynë në një transaksion joformal, d.m.th. të përcaktonte nëse paraqitësi i kërkesës kishte fituar të drejtën e pronësisë mbi pronën përmes një transaksioni joformal. Në rastet e tilla, KKPB-ja udhëzoi regjistrimin e së drejtës së krijuar në regjistrin kadastral përkatës. Transaksionet joformale në këtë kuptim janë transaksionet që janë bërë mes palëve, përkundër Ligjit që ekzistonte në vitin 1991 për ndryshime dhe plotësime për kufizimin e transaksioneve të pronave të paluajtshme (Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë, 22/91, 18 Prill 1991). Ky ligj kufizonte transaksionet e tilla joformale, pasi që kishte vendosur që ato rezikojnë "strukturën kombëtare të popullatës". Ky ishte shfuqizuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/10, e cila kishte hyrë në fuqi më 13 tetor 1999.

¹⁵ Më 24 mars 1999, Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior kishte nisur "Operacionin Forca Aleate", duke bombarduar Republikën Federale të Jugosllavisë, gjatë konfliktit në Kosovë. Kështu, kjo merret si data kur palët në Kosovë mund të kenë humbur të drejtat e tyre pronësore. Ky përcaktim njihet përmes Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/23, neni 1, paragrafi 1.2 (c), 15 nëntor 1999. Gjetet në <http://www.kpaonline.org/frameworkPDFs/01RE1999-23.pdf>, qasur më 19 mars 2020.

¹⁶ Derisa vendoste për kërkesat e kategorisë C, KKPB-ja përpjeqje vetëm të përcaktonte të drejtat e posedimit mbi pronën e pretenduar, përveç rasteve kur kishte kundër-kërkesa nga kategoria A për të njëjtën pronë. Shumica e kërkesave të kategorisë C u parashtruan nga pjesëtarët e zhvendosur të komunitetit serb.

¹⁷ Për më shumë detaje, shih Raportin Përfundimtar 2007, Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore, Kapitulli 5 (Pranimi dhe Regjistrimi i Kërkesave), Statistikat e numrit të kërkesave të pranuar, f. 40. Gjetet në http://www.kpaonline.org/hpd/pdf/HPCCFinal_Report.pdf, qasur më 21 gusht 2019.

¹⁸ Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, Përmbledhje gjithëpërfshirëse e gjendjes në Kosovë, nga i Dërguari Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB në Kosovë, Ambasadori Kai Eide, S/2005/635, 7 tetor 2005. <http://www.unosek.org/docref/KaiEidereport.pdf>, qasur më 11 mars 2019.

¹⁹ Këto ishin kërkesa të lidhura me konfliktin, përfshirë rrethanat që lidheshin drejtpërdrejt me të ose që rridhnin prej tij, mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

²⁰ Prania në terren përbëhej nga zyrat në terren në tërë Kosovën, si dhe në Podgoricë, Shkup, Beograd, Kragujevc dhe Nish.

²¹ Prandaj, ai përbëhej nga Sekretariati Ekzekutiv, Bordi Mbikëqyrës si dhe Komisioni i Kosovës për Kërkesa Pronësore (KKKP). Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronat e paluajtshme private, përfshirë pronat bujqësore dhe komerciale, 16 tetor 2006 (Rregullorja Nr. 2006/50).

²² Komisioni i Kosovës për Kërkesa Pronësore (KKKP) është organi vendimmarrës kuazi-gjyqësor brenda Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP), themeluar në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/10. Sipas kësaj, mandati i KKKP-së ishte zgjidhja e kërkesave pronësore të lidhura me konfliktin, si dhe kërkesave për të drejtë shfrytëzimi, lidhur me pronat e paluajtshme private, për shkak të rrethanave që lidheshin drejtpërdrejt ose që kishin lindur nga konflikti që kishte ndodhur ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999, ku pala kërkuese nuk ishte më në gjendje të gëzonte të drejtat e tilla pronësore. Pretendimet e lidhura me konteste pronësore, por që nuk lidheshin me konfliktin 1998-1999, ishin jashtë mandatit të KKKP-së, si dhe i nënshtroheshin shqyrtimit nga sistemi gjyqësor vendor. Ngjashëm, kërkesat që nuk përfshinin prona të paluajtshme private ishin jashtë mandatit të KKKP-së. KKKP-ja u autorizua të vërtetonte të drejtat pronësore dhe të shfrytëzimit të pretenduara nga palët, të jepte urdhra për lejimin e posedimit të pronës, duke përfshirë urdhra e dëbimit lidhur me uzurpuesit e paligjshëm, si dhe të aprovonte, të refuzonte, ose të hidhte poshtë pretendimet.

²³ Mandati i AKP-së u qartësua me Ligjin Nr. 03/L-079 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronat e paluajtshme private, përfshirë pronat bujqësore dhe komerciale, 15 qershor 2008 (Ligji

Në vitin 2011, si rezultat i dialogut Prishtinë-Beograd, i lehtësuar nga Bashkimi Evropian në Bruksel, palët arritën marrëveshje²⁴ që Beogradi t'i kthejë regjistrat kadastralë të Kosovës.²⁵ Në vitin 2016, u krijua AKKVP-ja, duke trashëguar një pjesë të mandatit të AKP-së dhe DÇPB-së.

Ligji për AKKVP-në²⁶ hyri në fuqi vetëm në nëntor të vitit 2016, pasi miratimi i tij nga Kuvendi i Kosovës (Kuvendi) në qershor të vitit 2016 u kontestua nga partia politike Lista Serbe. Partia pretendonte që Kuvendi kishte shkelur procedurat e votimit gjatë procesit të miratimit. Kështu, Lista Serbe kundërshtoi procedurën e Kuvendit në Gjykatën Kushtetuese më 17 qershor 2016. Mirëpo, më 25 tetor 2016, Gjykata vendosi që ankesa ishte e papranueshme dhe urdhëroi që procedurat të vazhdonin për hyrjen në fuqi të Ligjit për AKKVP-në.²⁷

Sipas nenit 4 të Ligjit për AKKVP-në (Funksonet dhe përgjegjësitë e AKKVP-së), paragrafi 2.1²⁸, Ligji ka paraparë përgjegjësitë e AKKVP-së për pranimin, krahasimin, e përmes Komisionit për Verifikim e Vendosje të Pronave (KVVP), zgjidhjen e mospërputhjeve mes periudhës para qershorit 1999 dhe të dhënave të regjistruara kadastralë të Kosovës të krijuara rishtazi lidhur me pronën private, pronën private komerciale dhe pronën private të bashkësive fetare, ku dy grupe të të dhënave kadastrale, ato para vitit 1999 dhe ato pas 2003 dallojnë mes veti.

AKKVP-ja po ashtu trashëgoi përgjegjësitë që më parë i përkisnin AKP-së, përkatësisht edhe të DÇPB-së. Ligji ka paraparë autoritetin ekzekutiv të AKKVP-së lidhur me zbatimin e vendimeve të AKP-së, DÇPB-së, KKP-së, Komisionit për Verifikim dhe Vendosje të Pronave (KVVP), Komisionit të Kërkesave Pronësore (KKP), aktgjykimeve të Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me AKP-në, përfshirë administrimin e pronave me kërkesën e parashtruesve të suksesshëm, zbatimin e skemave vullnetare të qiradhënies për pronat nën administrimin e saj,²⁹ rrënimin e strukturave ilegale të ndërtuara në pronat e personave të zhvendosur, si dhe dëbimin e uzurpuesve të paligjshëm. Për më tepër, të gjitha kompetencat e AKP-së, përfshirë buxhetin e saj, asetet fizike dhe detyrimet kontraktuese, u bartën po ashtu tek AKKVP-ja.

Nr. 03/L-079). Sipas të njëjtit ligj, autoriteti i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së u zëvendësua me Përfaqësuesin Special të Bashkimit Evropian/Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar, i cili u refuzua nga qeveria në Serbi. Si pasojë, zyrat e AKP-së në Beograd, Kragujevc dhe Nish u mbyllën, duke prekur në masë të madhe një numër të madh të kërkuarëve që banonin në këto zona. Kjo u zgjidh pas negociatave midis përfaqësuesve të AKP-së dhe zyrës së UNHCR-së në Prishtinë, si dhe zyrës së UNHCR-së me qendër në Beograd dhe qeverisë serbe, pas së cilës u ra dakord që zyrat pronësore të UNHCR-së të hapeshin për të kryer funksione të parapara më parë për AKP-në.

²⁴ "Konkluzë operative e grupit trepalësh të zbatimit për regjistrat kadastralë", 20 tetor 2011.

²⁵ Deri në kohën e përpilimit të këtij raporti (dhjetor 2019), krahasimi dhe verifikimi ende nuk ka ndodhur, pasi regjistrat kadastralë ende nuk janë kthyer në Prishtinë.

²⁶ Ligji nr. 05/L-010 për Agjencinë e Kosovës për Krahasim dhe Verifikim të Pronave, 28 nëntor 2016.

²⁷ Shqyrtimi i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 05/L-010 për Agjencinë e Kosovës për Krahasim dhe Verifikim të Pronave, http://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/KO94-16_ANG.pdf qasur më 28 qershor 2019.

²⁸ Neni 4 para. 2.1 të Ligjit nr. 05/L-010 për Agjencinë e Kosovës për Krahasim dhe Verifikim të Pronave, 28 nëntor 2016.

²⁹ Po aty. Neni 4 para. 2.2, 2.3, 2.4 dhe 2.5.

Prandaj, duke marrë parasysh mandatin e saj të gjerë, AKKVP-ja luan rol jetik në mbrojtjen e të drejtave pronësore të komuniteteve të cenueshme, veçanërisht atyre që jetojnë në zhvendosje. Mekanizmat janë qenësorë në vendosjen dhe zbatimin e një vëllimi të madh të kërkesave pronësore, të cilat përndryshe do ta kishin tejngarkuar sistemin e rregullt gjyqësor në Kosovë.

1.2 Fushëveprimi i raportit

Ky raport paraqet analizë të një periudhe njëzet vjeçare të funksionimit të mekanizmave të kërkesave në masë për zgjidhjen e kontesteve pronësore, të cilat janë veshur me kompetencë ekskluzive për të pranuar dhe vendosur për kërkesat pronësore, të lidhura me konfliktin, mbi pronat banesore, bujqësore dhe komerciale. Më saktësisht, mekanizmat e diskutuar janë DÇPB-ja (1999–2006), AKP-ja (2006–2016) dhe AKKVP-ja (themeluar më 2016), si tri agjenci që në vazhdimësi janë mandatuar të merren me zgjidhjen e kërkesave të tilla. Duke marrë parasysh që AKKVP-ja është akoma mekanizëm funksional, raporti vlerëson punën e tij që nga koha e themelimit të tij deri në dhjetor të vitit 2019. Ky shqyrton në detaje performancën e tyre, arritjet kryesore dhe mangësitë, si dhe reflekton mbi gjendjen aktuale në lidhje me zgjidhjen e kërkesave pronësore të lidhura me konfliktin në Kosovë, përballë mandatit të dhënë për këta mekanizma, si dhe faktorët tjerë që ndikuan në rezultatet e tyre.

Raporti së pari shtjellon kornizat ligjore dhe të politikave ndërkombëtare dhe vendore, të cilat përbëjnë bazën për të kuptuar rrethanat komplekse që kanë të bëjnë me pretendimet pronësore të lidhura me konfliktin në Kosovë. Së dyti, ky ofron një përmbledhje të shkurtër të krijimit të mekanizmave, rolin dhe përparimin e tyre, si dhe detyrimet dhe përgjegjësitë; arritjet dhe dështimet e identifikuara.

Kapitulli 3 Analiza e gjendjes ofron një analizë të thuktë të çështjeve vijuese:

- uzurpimi i paligjshëm dhe dëbimi;
- njoftimet;
- skema e administrimit/qiradhënies;
- rrënimi;
- shqyrtimi paralel i rasteve në gjykata;
- Kërkesat e kategorisë A dhe C, si dhe
- aspektet financiare dhe të personelit.

Ky kapitull do të diskutojë numrin e uzurpimeve të paligjshme dhe dëbimeve, si dhe situatën në lidhje me mjetet juridike të parapara. Kapitulli shqyrton njoftimet fizike bazuar në numrin e saktë të njoftimeve të shpërndara, si dhe sfidat që vazhdimisht paraqiten kur bëhet fjalë për njoftimet efektive dhe me kohë. Më tej, raporti i referohet numrit të pronave nën administrim ose skemën e qiradhënies, duke paraqitur kështu edhe luhatjet e shifrave përgjatë viteve. Kapitulli për rrënimin e objekteve të

paligjshme në pronat e palëve kërkuese shqyrton pengesat dhe arsyet kryesore pse të dyja, AKP-ja dhe AKKVP-ja nuk kanë arritur të ushtrojnë këtë përgjegjësi. Për më tepër, këtu përfshihet edhe numri i rasteve të paraqitura paralelisht në gjykatat e rregullta, si dhe të dhënat e mbledhura për kategorinë A të kërkesave (humbje në bazë diskriminimi e të drejtës së banimit para vitit 1989) dhe asaj C (të drejtat e pronësisë ose posedimit të fituara pas vitit 1989), përfshirë numrin e rasteve të ndodhura dhe arsyet e mos-zgjidhjes së tyre. Së fundmi, raporti po ashtu përshkruan një numër sfidash të hasura financiare dhe të personelit, të cilat kanë ndikuar në punën e mekanizmave të kërkesave në masë.

Në kapitullin e tij të fundit, raporti jep një numër përfundimesh bazuar në gjetjet e paraqitura në pjesën kryesore dhe rekomandimet që i drejtohen palëve të interesit të sotme, të përfshira në raste që kanë të bëjnë me të drejtat pronësore, e të lidhura me konfliktin në Kosovë.

1.3 Metodologjia

Ky raport përdor të dhëna cilësore dhe sasiore. Intervistat me nëntë palë relevante të interesit në fushën e të drejtave pronësore në Kosovë³⁰ janë kryer në periudhën mes gushtit dhe dhjetorit 2018. Ato kanë shërbyer si burim i të dhënave cilësore, të përdorura kryesisht në Kapitullin 3 (Analiza e gjendjes).³¹ Për më tepër, OSBE-ja ka shkëmbyer rregullisht informata lidhur me çështjet e të drejtave pronësore me të gjitha institucionet, përfaqësuesit e të cilëve janë intervistuar për qëllime të këtij raporti. Duke marrë parasysh këtë, intervistat e kryera janë rezultat i bashkëpunimit ekzistues, derisa të gjithë të intervistuarit kanë qenë të angazhuar dhe janë të njoftuar mirë me punën e të tre mekanizmave të përmendur të shqyrtimit të kërkesave në masë.

Për më tepër, burimet më të rëndësishme të të dhënave sasiore janë raportet përfundimtare të DÇPB-së, dhjetë raporte vjetore të publikuara nga AKP-ja, si dhe raportet vjetore të AKKVP-së. Në fund, të dhënat e mbledhura përmes monitoruesve të OSBE-së në terren dhe shkëmbimit të vazhdueshëm të informatave me palët e interesuara përkatëse janë përdorur për të vërtetuar gjetjet në këtë raport.

³⁰ Për të mbledhur informata nga vendi i ngjarjes, OSBE-ja iu është drejtuar përfaqësuesve të institucioneve vijuese: AKKVP, UNHCR, Projektit të Bashkimit Evropian (BE) për Ndhimë Juridike në Serbi, njërit anëtar të Bordit Mbikëqyrës të AKKVP-së (Përfaqësuesi Special i BE-së), Gjykatës Kushtetuese, Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës, Ministrisë së Drejtësisë, si dhe OJQ-së "Të drejtat e Banimit Social dhe Pronës", që fokusohet në të drejtat pronësore të personave të zhvendosur dhe komuniteteve jo-shumicë. Pyetjet e intervistës synonin të zbulonin qëndrimin e të intervistuarve në lidhje me ushtrimin e mandatit nga mekanizmat e kërkesave pronësore të lidhura me konfliktin. Ato përqendroheshin veçanërisht në përcaktimin se sa të suksesshëm kanë qenë mekanizmat në tejkalim të sfidave me të cilat janë përballur, pra sa i suksesshëm ishte administrimi i pronave dhe skema e qiradhënies; si ndikoi rishikimi paralel i rasteve nga gjykatat e rregullta në punën e mekanizmave; si është vepruar me dëbimin e sërishëm të uzurpuesve të paligjshëm, si dhe në çfarë mase kanë qenë të suksesshëm në njoftimin e palëve kërkuese dhe kryerjen e rrënimëve.

³¹ OSBE mban bashkëpunim të mirë me të gjitha palët e përmendura; prandaj nuk ka pasur ndonjë sfidë metodologjike për t'iu qasur të dhënave të kërkuara.

2.KORNIZA LIGJORE DHE AJO E POLITIKAVE NDËRKOMBËTARE DHE VENDORE

Instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut vënë theks të posaçëm në mbrojtjen e të drejtave pronësore. Në nenin 17 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut (DUDNJ), dokumenti i parë që përkufizon të drejtat themelore të njeriut që duhen mbrojtur universalisht, thotë se “Gjithkush ka të drejtën të ketë pasuri, si vetëm ashtu edhe në bashkësi me të tjerët” dhe se “asnjëri nuk mund të privohet arbitrarisht nga pasuria e tij.”³² Për më tepër, e drejta e pronës është theksuar edhe nga Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (ICERD),³³ dhe Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW)³⁴.

Të drejtat pronësore përcaktohen vetëm në Protokollin e Parë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), e jo brenda vetë Konventës.³⁵ Sidoqoftë, të drejtat pronësore janë ndër të drejtat më të shkelura në nivel ndërkombëtar. Në vitin 2018, për shembull, 8.59 për qind e të gjitha aktgjykimeve në të cilat ka gjykuar Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) kanë gjetur shkelje të dispozitës së të drejtës pronësore të KEDNJ-së, ndërsa për periudhën 1959–2018, kjo arrin në 11.59 për qind.³⁶

Për më tepër, Parimet e Kombeve të Bashkuara për Banimin dhe Kthimin e Pronave për Refugjatët dhe Personat e Zhvendosur (Parimet Pinheiro) përfaqësojnë një nga standardet më të rëndësishme ndërkombëtare që përshkruan të drejtat e refugjatëve dhe personave të zhvendosur për t'u kthyer në shtëpitë dhe tokat e tyre.³⁷

³² Neni 17 (1) dhe neni 17 (2), “Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut”, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së. 217 (III) A (Paris, 1948). Gjetet tek <http://www.un.org/en/universal-declaration-human-rights/>, qasur më 23 korrik 2018.

³³ Neni 5 (d)(v), Konventa ndërkombëtare për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, 21 dhjetor 1965, Kombet e Bashkuara, Seria e traktateve, vëll. 660, f. 195. Gjetet tek <https://www.coe.int/en/web/compass/148>, qasur më 23 korrik 2018.

³⁴ Neni 16 (h), Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, 18 dhjetor 1979, Kombet e Bashkuara, Seria e traktateve, vëll. 1249, f. 13. Gjetet tek <http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/cedaw.htm>, qasur më 23 korrik 2018.

³⁵ “Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose gjobave tjera. Këshilli i Evropës, Protokollin 1 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, 20 mars 1952, ETS 9. Gjetet në: https://www.echr.coe.int/Documents/Convention_ENG.pdf, qasur më 23 korrik 2018.

³⁶ Këshilli i Evropës, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në Fakte dhe Shifra, 2018, f. 7. Gjetet në: https://www.echr.coe.int/Documents/Facts_Figures_2018_ENG.pdf, qasur më 23 qershor 2019. Shihni gjithashtu Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Përmbledhje 1959-2018, Mars 2019. Gjetet në: https://www.echr.coe.int/Documents/Overview_19592018_ENG.pdf, qasur më 23 qershor 2019.

³⁷ Nën-Komisioni i OKB-së për Promovimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, Parimet për Banimin dhe Kthimin e Pronave për Refugjatët dhe Personat e Zhvendosur, 28 qershor 2005, E/CN.4/Sub. 2/2005/17. Gjetet në <https://2001-2009.state.gov/documents/organization/99774.pdf>, qasur më 20 qershor 2019.

Të miratuara në vitin 2005, ato janë rezultat i negociatave pothuajse dhjetëvjeçare për të prodhuar një dokument që jep udhëzime praktike dhe të konsoliduara se si të trajtohen çështjet e ndjeshme që kanë të bëjnë me banimin, tokën dhe kthimin e pronave përmes një qasjeje universale. Parimet Pinheiro gjithashtu përcaktojnë detyrimet e autoriteteve ndaj personave të zhvendosur, përfshirë nevojën për masa adekuate për të promovuar kthimet dhe mjetet efektive në dispozicion kundër shkeljeve të të drejtave të njeriut. Këto pasqyrohen gjithashtu në Parimet Udhëzuese të Kombeve të Bashkuara për zhvendosjen e brendshme.³⁸

Sa i përket kornizës ligjore të Kosovës lidhur me drejtat e pronës private, në fund të konfliktit të vitit 1999, UNMIK-u u zotua të sigurojë kthimin e sigurt dhe të papenguar të të gjithë refugjatëve dhe personave të zhvendosur në shtëpitë e tyre në Kosovë sipas nenit 11 (k) të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.³⁹ Më tej, neni 156 i Kushtetutës thotë qartë se:

“Kosova duhet të promovojë dhe lehtësojë kthimin e sigurt dhe të dinjitetshëm të refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit, si dhe t'i ndihmojë ata në rimarrjen e pronës dhe posedi meve të tyre.”⁴⁰

Për më tepër, Strategjia e Kosovës për të Drejtat Pronësore, e miratuar nga qeveria në vitin 2017, ofron vizion strategjik për përfundimin dhe sigurimin e të drejtave pronësore për të gjithë, duke njohur në veçanti “sfidat me të cilat përballen gratë, personat e zhvendosur (PZH) dhe anëtarët e komuniteteve jo-shumicë në ushtrimin e plotë e praktikë të të drejtave të tyre mbi pronën, si dhe propozon masa specifike për të adresuar këto sfida”⁴¹. Përveç kësaj, Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore,⁴² është ligj themelor që përcakton të drejtat dhe obligimet pronësore, derisa Ligji për tatimin mbi pronën e paluajtshme,⁴³ dhe Ligji për ndarjen, shfrytëzimin dhe shkëmbimin e pasurisë së paluajtshme komunale,⁴⁴ gjithashtu përmban dispozita që e trajtojnë çështjen e të drejta pronësore. Për më tepër, Ligji për Procedurën e përmbarimit⁴⁵ është një tjetër instrument kryesor që mundëson ekzekutimin e vendimeve, përfshirë vendimet që lidhen me të drejtat pronësore.

³⁸ Komisioneri i Lartë i OKB-së për Refugjatët (UNHCR), Parimet Udhëzuese për Zhvendosjen e Brendshme, 22 korrik 1998, ADM 1.1, PRL 12.1, PRO0/98/109. Gjetet në: <http://www.unhcr.org/protection/idps/43ce1cff2/guiding-principles-internal-displacement.html>, qasur më 24 korrik 2017.

³⁹ Neni 11 (k), Këshilli i Sigurimit i OKB-së, Rezoluta 1244, 1999 e Këshillit të Sigurimit (për vendosjen e pranisë ndërkombëtare civile dhe të sigurisë në Kosovë), 10 qershor 1999, S/RES/1244 (1999). Gjetet në: <https://documents-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/N99/172/89/PDF/N9917289.pdf?OpenElement>, qasur më 24 korrik 2018.

⁴⁰ Article 156 (Refugees and Internally Displaced Persons), Kosovo Constitution, 15 June 2008.

⁴¹ “Strategjia Nacionale e Kosovës për të Drejtat Pronësore”, Ministria e Drejtësisë, Dhjetor 2016, f. 7. Gjetet në http://kryeministks.net/repository/docs/National_Strategy_and_Annexes_ENG.pdf. Qasur më 16 maj 2019.

⁴² Ligji nr. 2009/03-L-154 për Pronën dhe të drejtat tjera sendore, 25 qershor 2009. Gjetet në https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2009_03-L-154_en.pdf, qasur më 3 Prill 2019.

⁴³ Ligji Nr. 06/L-005 për Tatimin mbi Pronën e Paluajtshme, miratuar më 15 shkurt 2018. Gjetet në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15984>, qasur më 9 Prill 2019.

⁴⁴ Ligji nr. 06/L-092 për Dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunave, miratuar më 7 mars 2019. Gjetet në <https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2017/10/LAW-NO-6.pdf>, qasur më 3 Prill 2019.

⁴⁵ Ligji nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, 3 janar 2013. Gjetet në <https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Law%20on%20enforcement%20procedure.pdf>, qasur më 3 Prill 2019.

3. ANALIZË E SITUATËS

3.1 Uzurpimi dhe dëbimi

Uzurpimi dhe riuzurpimi i pronave ka mbetur sfidë e vazhdueshme gjatë zbatimit të procesit të riposedimit të pronës. Pengesa kryesore është lidhur pashmangshmërisht me faktin që mandatet e DÇPB, AKP dhe AKKVP lejonin dëbimin nga pronat e riuzurpuara vetëm dy herë, ndërsa kishte raste kur pronat e njëjta ishin riuzurpuar disa herë. Gjatë mandatit të tij, DÇPB kreu gjithsej 2,168⁴⁶ dëbime në të gjithë Kosovën (Figura 1). Sidoqoftë, numri i pronave të riuzurpuara pësoi rënie me kalimin e kohës,⁴⁷ veçanërisht pas nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit (MM) në mes Policisë së Kosovës (PK) dhe AKP-së, në tetor të vitit 2009.⁴⁸ Ky Memorandum përvijoi detyrimet dhe procedurat paraprake që duhen ndjekur në lidhje me ndihmën e PK-së në ekzekutimin e dëbimeve, pas kërkesës së paraqitur nga AKP.⁴⁹ Për më tepër, uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme përbën vepër penale, sipas Kodit Penal të Kosovës (KPK)⁵⁰. Sipas raportit të AKP-së të vitit 2013, marrëveshja për trajtimin e çështjeve të tilla u arrit më 23 gusht të vitit 2012 mes PK-së dhe prokurorëve. Sipas marrëveshjes së re, riuzurpuesit përsëritës duhet të arrestohen dhe dënohen përmes sistemit gjyqësor, në përputhje me Kodin Penal. Besohej se arrestimi dhe ndalimi janë më efektive në parandalimin e rasteve të riuzurpimit të përsëritur se sa absorbimi i burimeve të vlefshme të AKP-së dhe PK-së për t'i dëbuar të njëjtët uzurpues të paligjshëm në të njëjtën pronë në mënyrë të përsëritur.⁵¹




Figura 1: Dëbimet e kryera nga DÇPB

⁴⁶ Statistikat e DÇPB-së, 2005. Në dispozicion në <http://www.kpaonline.org/hpd/pdf/Statistics%20Annual%20English.pdf>, qasur më 1 korrik 2019.

⁴⁷ Bazuar në raportet vjetore të DÇPB-së dhe AKP-së nga viti 2000 deri në vitin 2018.

⁴⁸ MM përvijon obligimet dhe procedurat sa i përket ekzekutimit të dëbimeve.

⁴⁹ AKP ka nënshkruar MM me Policinë e Kosovës, 19 tetor 2009. Për më shumë informacione luteni të shihni <http://www.kpaonline.org/detailRel.asp?ID=50>.

⁵⁰ Neni 332 i Kodit Penal të Kosovës 22 qershor 2012. E njëjta u përsërit nga Kodi i ri Penal i Kosovës Nr. 06/L-074, neni 320, 14 janar 2019.

⁵¹ Raporti Vjetor i KPA-së nga 2013, f. 27. Gjetendet në <http://www.kpaonline.org/PDFs/AR2013.pdf>, qasur më 1 korrik 2019.

Siç tregojnë të dhënat në Figurën 2, në fund të mandatit të saj në vitin 2016, AKP-ja arriti të zbatojë 6.948 dëbime, ndërsa 2.043 u anuluan për arsye të ndryshme.⁵² Në disa raste, për shembull, dëbimet ishin planifikuar si rezultat i mospagimit të qirasë nga qiramarrësi që banonte përkohësisht në pronë nën administrim/skemën e qiradhënies. Atëherë kur pagesa për qiranë bëhej në ndërkohë, dëbimi anulohet. Për më tepër, në raste të uzurpimeve të pronave, uzurpuesi shpeshherë largohej vullnetarisht nga prona, duke e bërë dëbimin e planifikuar të panevojshëm dhe për këtë shkak anulohet. Gjithashtu, ka edhe 387 raste shtesë në pritje të dëbimeve ku përfshihen kallëzime penale⁵³ për shkak të uzurpimit të pronës së paluajtshme. Këto lëndë u dërguan në zyrën e prokurorit përkatës për përpunim të mëtutjeshëm.

NUMRI TOTAL I DËBIMEVE TË ZBATUARA NGA AKP GJATË MANDATIT TË SAJ 2006-2016




Figura 2: Numri total i dëbimeve të zbatuara nga AKP gjatë mandatit të saj 2006-2016

Për më tepër, rrethanat politike ndikuan në punën e mekanizmave, veçanërisht në komunat veriore të Kosovës. Procesi i dëbimit i mbështetur nga PK në këtë zonë ishte penguar në janar 2010, për shkak të rrethanave të përgjithshme politike që krijojnë shqetësime për sigurinë. Sidoqoftë, AKP, deri në gusht 2011, vazhdoi me dëbime në mënyrë plotësisht të pavarur. Në disa raste të ndjeshme, procedura u mbështet nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX). Nga gushti 2011 deri në mars 2014, për arsye sigurie nuk u ekzekutua asnjë dëbim. Pas marsit 2014, dëbimet në komunat veriore rifilluan deri në fund të vitit 2016. Gjatë kësaj periudhe, u realizuan vetëm 13 dëbime.⁵⁴ Kjo përfshinte raste në të cilat rreziku i sigurisë nuk ishte vlerësuar i lartë nga Agjencia dhe PK. Siç tregohet në Figurën 3, kjo bëri që AKP të kishte 640 raste të lëna pezull në kohën kur u mbyll.⁵⁵

⁵² Kapitulli 5.6.3. "aktivitetet e dëbimit" të Raportit Vjetor të AKKVP 2016, f. 159. Gjetet në http://www.kpaonline.org/PDFs/Raporti_2016.pdf, qasur më 2 tetor 2019.

⁵³ Raste të tilla përfshinin riposedime të paligjshme, uzurpime, mospagesë të qirasë, dhe refuzim për të hyrë në marrëveshje të qiramarrjes. Ju lutemi shihni Kapitullin 5.6.3. "Aktivitetet e dëbimit" të Raportit Vjetor të AKKVP të 2016, f. 159. Gjetet në http://www.kpaonline.org/PDFs/Raporti_2016.pdf, qasur më 1 korrik 2019.

⁵⁴ Shih Kapitullin 5.6.3. "Aktivitetet e dëbimit" të Raportit Vjetor të AKKVP nga 2016, f. 159.

⁵⁵ Po aty, f. 158-159. Gjetet në http://www.kpaonline.org/PDFs/Raporti_2016.pdf, qasur më 1 korrik 2019.




Figura 3: Numri i rasteve të dëbimeve në pritje në vitin 2016

Arsyet për numrin e mbetur të dëbimeve të porealizuara në fund të mandatit të AKP-së ishin si më poshtë:⁵⁶

**ZBËRTHIMI I SHKAQEVE TË RASTEVE TË AKP-së NË PRITJE TË DËBIMIT NË
FUND TË 2016**

	Riposedim	Uzurpim i paligjshëm	Mospagesë e qirasë	Refuzim për hyrje në marrëveshje qiraje	Pritje për dëbim nga PK
Gjilan	0	3	1	0	17
Pejë	1	53	18	0	108
Prishtinë	1	8	0	0	34
Prizren	1	0	0	0	29
Mitrovica Jugore	2	15	60	28	14
Mitrovica Veriore	12	1	58	3	173

Figure 4: Numri i dëbimeve në pritje në 2016

Ekzekutimi i të gjitha dëbimeve të planifikuara është gjithashtu një sfidë me të cilën përballet AKKVP. Të dhënat zyrtare tregojnë se gjatë vitit 2018, AKKVP kishte planifikuar 906 dëbime. Ndonëse 321 prej tyre ishin zbatuar dhe pronat ishin liruuar, 86 dëbime janë anuluar, ndërsa 83 dëbime mbetën në pritje në fund të vitit 2018.⁵⁷

⁵⁶ Po aty, f. 159.

⁵⁷ Raporti Vjetor i AKKVP 2018. Gjetendet në http://kpcva.org/pdf/Raporti_2018.pdf, f. 129, qasur më 19 mars 2020.

Kjo, megjithatë, tregon se AKKVP ka qenë më e suksesshme në zbatimin e kësaj përgjegjësie sesa pararendësja e saj.

Figura 5 pasqyron numrin e dëbimeve në pritje në fund të vitit 2019.




Figura 5: Pronat e uzurpuara ndarë sipas rajonit dhe etnisë së parashtruesve të suksesshëm dhe uzurpuesve

Siç u tregua më lart, numri i përgjithshëm i pronave të uzurpuara që i nënshtrohen dëbimit është 46. Rajoni i Mitrovicës, me 24 raste, ka numrin më të madh të pronave të uzurpuara që i nënshtrohen dëbimit. Në këtë rajon, 22 prona që u përkasin shqiptarëve në Mitrovicën Veriore janë uzurpuar nga serbët, ndërsa dy prona që u përkasin serbëve në Mitrovicë Jugore janë uzurpuar nga shqiptarët. Në rajonin e Prishtinës, nga dhjetë prona të uzurpuara që i përkasin serbëve, nëntë janë të uzurpuara nga shqiptarët dhe një nga një uzurpues i panjohur. Për më tepër, në rajonin e Pejës me nëntë prona të uzurpuara që i nënshtrohen dëbimit, shtatë u përkasin serbëve, një i përket një boshnjaku dhe një i përket një kompanie private. Tetë nga këto prona janë të uzurpuara nga shqiptarët, dhe një nga një uzurpues i panjohur. Në rajonin e Prizrenit me tre prona që i nënshtrohen dëbimeve, dy nga të cilat u përkasin serbëve dhe një që i përket një romi, janë uzurpuar ilegalisht nga shqiptarët. Vetëm në rajonin e Gjilanit nuk ka prona të uzurpuara në mënyrë të paligjshme ose ndonjë dëbim të planifikuar.

Ndonëse AKKVP ka qenë më e suksesshme në zbatimin e kësaj përgjegjësie në krahasim me paraardhësin e saj, efikasiteti i procesit është ndikuar nga miratimi në pritje i ndryshimeve e plotësimeve të Ligjit për AKKVP-në, gjë që do t'i mundësonte AKKVP-së kryerjen e më shumë dëbimeve. Mirëpo, përkundër faktit që ndryshimet e plotësimet e Ligjit janë miratuar nga qeveria dhe dërguar në Kuvend për miratim më 6 shtator 2018, ato kanë mbetur në Kuvend që atëherë. Jostabiliteti politik dhe mungesa e shpeshtë e kuorumit në Kuvend e ka vonuar miratimin e ndryshimeve e plotësimeve të ligjit. Rrjedhimisht, kur flasim për kryerjen e më shumë dëbimeve, AKKVP mbetet e lidhur për kornizën ligjore që aktualisht është në fuqi.

Për më tepër, Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) gjithashtu kishte vërejtur situata (p.sh. çështja e Nadežda Jovanović) ku AKP nuk kishte arritur ta informojë me shpejtësi policinë për uzurpimin e pronës, duke kontribuar kështu edhe më tepër në shtyrjen e procesit të riposedimit të pronës. Siç u theksua në raportin e IAP-së për shkeljen e së drejtës së pronës, të drejtës për barazi para ligjit dhe për kohëzgjatjen e procedurës në ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese nga viti 2015,⁵⁸ për shkak të reagimit të ngadaltë në nivelin e ndjekjes dhe të gjyqësorit, proceset e zgjidhjes së çështjeve ishin zgjatur gjithashtu.⁵⁹ Për më tepër, IAP-ja vërejti se vendimet e Gjykatave Supreme dhe Kushtetuese shpesh dështuan të ekzekutoheshin. Kjo ka rezultuar në shkeljen e të drejtës së ankuesve "për gëzimin paqësor dhe të papenguar të pronës, në përputhje me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ".⁶⁰ Raporti i IAP vërejti se "mbrojtja kushtetuese dhe ligjore e të drejtave të pronës nuk ka kuptim nëse nuk mbrohet edhe në praktikë", e që është arsyeja pse zbatimi i instrumenteve ekzistues për mbrojtjen e të drejtave pronësore mbetet thelbësor.

Në lidhje me rastet e riuzurpimit të paligjshëm, kur vendimet e mëpasshme të gjykatës urdhëruan përdorimin e përmbauesve privatë për të ekzekutuar dëbimet, Ligji për procedurën përmbaimore⁶¹ vendos ngarkesë shtesë për personat e zhvendosur, si në aspektin e kohës, ashtu edhe të parave. Nenin 13 (shpenzimet e përmbaimit), paragrafi 1, thotë se "Shpenzimet e procedurës lidhur me caktimin dhe kryerjen e përmbaimit paraprakisht i paguan kreditori." Kjo praktikisht nënkupton që kostot e dëbimit duhet të paguhet nga paraqitësi i kërkesës, dhe më vonë të rimbursohen

⁵⁸ Për më shumë informacion, shih Raportin Vjetor 2015, të Institucionit të Avokatit të Popullit në Kosovë, 2.10 Ankesa nr. 435/2013 Nadežda Jovanović kundër KPA në lidhje me ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Supreme KI 187/13, fq 83-84; si dhe të Institucionit të Avokatit të Popullit, Përmbledhja e raporteve drejtuar autoriteteve përkatëse gjatë vitit 2016, Prishtinë, 2017, fq 140-141. Në dispozicion në www.theioi.org/downloads/144hj/kosovo_om_annual-report_2016_en-1.pdf, qasur më 20 qershor 2019.

⁵⁹ Intervistë me përfaqësuesit e Institucionit të Avokatit të Popullit në Kosovë (znj. Suzana Gashi), më 31 gusht 2018.

⁶⁰ Raporti Vjetor 2015, Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë, 2.10 Ankesa nr. 435/2013 Nadežda Jovanović kundër AKP-së në lidhje me ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Supreme KI 187/13, fq 83-84. Në dispozicion në <http://www.eoi.at/d/EOI%20-%20Jahresberichte/Kosovo/Kos-English%20Annual%20Report%202015%20351292.pdf>, qasur më 1 korrik 2019.

⁶¹ Ligji Nr. 04 / L-139 për Procedurën përmbaimore, 3 janar 2013. Në dispozicion në <https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/liqjet/Law%20on%20engment%20procedure.pdf>, qasur më 19 qershor 2019.

sipas këtij neni.⁶² Megjithatë, në përputhje me Parimin Pinheiro 13.2,⁶³ shpenzimet e tilla nuk duhet t'i vendosen personave të zhvendosur, pasi ato mund të përbëjnë barrierë financiare. Parimet e Pinheiros parashohin një proces apeli "pa pagesë", dhe në përputhje me këtë, shpenzimet e përmbartimit privat nuk duhet të barten nga personat e zhvendosur që janë në kushte të pasigurta ekonomike.

Prandaj, kjo nënvizon rëndësinë e përafrimit të kornizës ligjore të Kosovës me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave pronësore. Vetëm pas harmonizimit të tyre të plotë, të mbështetur nga veprimi i shpejtë nga prokuroria dhe gjykatat, dhe i ndjekur nga zbatimi i vendimeve të tyre, është e mundur të krijohet një mjedis i përshtatshëm për zbatimin e plotë të të drejtave pronësore për të gjithë.

3.2 Njoftimi fizik i pronave

Një pengesë tjetër e rëndësishme në përmbushjen e detyrave nga mekanizmin ishte lidhur me njoftimin fizik të pronave - hap thelbësor në të cilin palët me interes legjitim në pronën e kërkuar u njoftuan për kërkesën, dhe të cilëve u jepet mundësia për të marrë pjesë në procedurë. Në rastin e DÇPB-së, dispozitat në Rregulloren e UNMIK-ut 2000/60 adresonin dhe rregullonin pjesëmarrjen e palëve në proces për të siguruar që procedurat e saj plotësonin standardin e procesit të drejtë.⁶⁴ DÇPB-ja ishte e detyruar të ndërmarrë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të njoftuar pronarin e pronës së kërkuar dhe çdo palë tjetër me interes legjitim në pronë në lidhje me paraqitjen e kërkesës, dhe të drejtën e tyre për të marrë pjesë në procedurë.⁶⁵

Për më tepër, procesi i njoftimit fizik të pronave nga AKP duhej bazuar në të dhënat e regjistrave kadastralë për të identifikuar vendndodhjen e pronave të kërkuara. Sidoqoftë, vetëm pas 13 korrikut 2009, kur AKP dhe Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) lidhën memorandum mirëkuptimi, AKP-së iu mundësua qasja në adresat e pronave.⁶⁶ Një krahasim i të dhënave të AKP-së të përdorura në procesin e njoftimit të pranuar nga paraqitësit e kërkesave me të dhënat zyrtare kadastrale tregoi se një numër i konsiderueshëm i adresave të dhëna në "njoftimet e formularëve të kërkesave"⁶⁷ nuk korrespondonin me vendndodhjen e parcelave të regjistruara në regjistrin zyrtar të të dhënave kadastrale. Prandaj, për shkak të këtyre mospërputhjeve të zbuluara, AKP ishte e detyruar të lëshoj serish gjithsej 31.544 ⁶⁸

⁶² Neni 4 (2) i Ligjit Nr. 04 / L-139 për Procedurën përmbartimore, 3 janar 2013: "debitori do ti rimbursojë kreditorit shpenzimet procedurale dhe të gjitha shpenzimet e tjera të bëra gjatë procedurës përmbartimore".

⁶³ Parimi 13.2 thotë që palët: Duhet të sigurojnë që të gjitha aspektet e procesit të kërkesave për restituim, përfshirë procedurat e ankesave, të jenë të drejta, me kohë, të arritshme, pa pagesë, dhe me konsideratë ndaj moshës dhe gjinisë. Shtetet duhet të miratojnë masa pozitive për të siguruar që gratë të jenë në gjendje të marrin pjesë në një bazë plotësisht të barabartë në këtë proces.

⁶⁴ Raporti Përfundimtar i Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore, 2007, f. 41. Në dispozicion në: www.kpaonline.org/hpd/pdf/HPCC-Final_Report.pdf, qasur më 8 prill 2019.

⁶⁴ Ky detyrim përfshinte gjithashtu njoftimin e palëve të interesuara për periudhat kur agjencia përkatëse mbledhi kërkesat, kur kërkesat ishin në proces të vendimmarrjes, pas përfundimit të procesit të gjykimit, si dhe kur procesi gjindej në fazën e dorëzimit pranë KKP dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme. Shihni seksionin 9.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

⁶⁵ Para Memorandumit të Mirëkuptimit, zyrtarët e AKP kishin qasje të kufizuar në të dhënat e AKK-së.

⁶⁶ Shenja sqaruese që tregojnë hollësitë e kërkesës dhe natyrën e së drejtës pronësore që kërkohet mbi pronën

⁶⁷ Intervistë me përfaqësuesen e AKKVP (Znj. Florije Kika, Ushtruese e detyrës drejtor), 3 gusht 2018.

⁶⁸ Intervistë me përfaqësuesen e UNHCR (Znj. Milena Tasevska), 2 gusht 2018.

njoftime, duke shkaktuar vonesa të mëdha në zgjidhjen e kërkesave. Në fakt, figura 6 më poshtë tregon se 73.79 për qind e numrit të përgjithshëm të çështjeve kërkuar njoftim të serishëm.




Figura 6: Rastet e njoftimit të serishëm nga AKP

Në pengesat e tjera përfshihej dokumentacioni jo i plotë i paraqitur nga kërkuesit që nuk ishin në gjendje të merrnin dokumentet e nevojshme në Kosovë. Si pasojë, raste të tilla nuk mund të rishikoheshin ose gjykoreshin, gjë që vonoi më tej zgjidhjen e tyre. Vështirësi dolën edhe nga mbyllja e zyrave të AKP në Serbi në qershor të vitit 2008, të cilat ishin përgjegjëse për dorëzimin e vendimeve kërkuesve të zhvendosur në Serbi, dhe ndarjen e të gjitha informacioneve që lidhen me kërkesat. Përkundër faktit se kjo çështje u zgjidh më vonë, me një memorandum të nënshkruar me UNHCR në Prishtinë për zyrat pronësore nën ombrellën e UNHCR në Serbi për të mbështetur AKP në kryerjen e kësaj detyre,⁶⁹ mbyllja pasuese e këtyre zyrave pezulloi më tej proceset e njoftimit. Prandaj, njoftimi i kërkuesve që banojnë jashtë Kosovës u bë sfidues, veçanërisht në lidhje me rastet e njoftimit për rezultatit e procedurave të përfunduara.

Përkundër sfidave të përmendura më lart, në kohën e mbylljes së saj, AKP kishte kryer njoftimin fizik të pronave në të gjitha 42.749⁷⁰ rastet që kishte trajtuar (figura 7). Rrjedhimisht, nuk kishte nevojë që kjo përgjegjësi të mbetej pjesë e mandatit të AKKVP.

⁷⁰ Kishte 16.903 njoftime të kryera, 87 njoftime të kryera (prona të pagjetura), 225 njoftime të kryera përmes publikimit, 25.477 njoftime të kryera përmes botimit në gazetë, ndërsa në 57 raste njoftimi nuk ishte i nevojshëm. Nuk ka të dhëna të disponueshme që kanë të bëjnë me njoftimet e kryera nga DQPB. Ju lutemi shikoni Kapitullin 5.2 të Raportit Vjetor të KPA/AKKVP nga viti 2016, faqe 147.

ZBËRTHIM I NJOFTIMEVE FIZIKE TË KRYERA NGA AKP




Figura 7: Njoftimet fizike nga AKP

Megjithatë, përkundër faktit se të gjitha palët me interes juridik ishin njoftuar në kohën e mbylljes së AKP-së, vonesat e shkaktuara nga nevoja për njoftim të serishëm në shumicën dërmuese të rasteve, si dhe pengesat e tjera të lartpërmendura me të cilat u përball AKP, ndikuan ndjeshëm në performancën e tij në fazat e hershme të funksionimit të tij.

3.3 Skema e administrimit/qiradhënies

Për të siguruar mbrojtje ligjore dhe fizike të pronave të vendosura nën administrim, si dhe për të siguruar burim të ardhurash për paraqitësit e suksesshëm të kërkesave, neni 1.1 (b) i Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 kishte paraparë themelimin e një skemë të qiradhënies që do të vendosej për pronat nën administrim. Mirëpo, për shkak të natyrës së ndjeshme politike të çështjes, skema e qiradhënies u aprovua nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (PSSP) vetëm në prill të vitit 2006. Pavarësisht se skema e qiradhënies u propozua gjatë gjithë viteve të operimit të DÇPB-së, zbatimi i saj ishte kushtëzuar edhe nga pëlqimi i qartë i Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ), që u dha në gusht 2006.⁷¹ Si pasojë, skema u funksionalizua vetëm në tetor 2006. Përveç kësaj, Ligji me të cilin u krijua AKP gjithashtu e kishte mandatuar atë që të merrte prona të reja nën administrimin e saj, si dhe të vazhdonte zbatimin e skemës ekzistuese të qiradhënies.⁷²

Sipas skemës, çdo pronë e vendosur nën administrimin e AKP ishte gjithashtu e disponueshme për marrje me qira pas pëlqimit të dhënë nga parashtruesi i kërkesës dhe vlerësimit të AKP-së që gjendja e pronës është e përshtatshme për qiradhënie. Qiramarrësit ishin të detyruar t'i paguanin qira mujore kërkuarit të suksesshëm përmes AKP-së. Në këtë mënyrë, bartësit e zhvendosur të drejtave pronësore arritën

⁷¹ Raporti Përfundimtar i Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore, 2007, f. 69. Në dispozicion në www.kpaonline.org/hpd/pdf/HPCC-Final_Report.pdf, qasur më 3 prill 2019.

⁷² Rregulloret e UNMIK-ut 1999/23 dhe 2000/60 autorizuan DÇPB-në që t'i vendosë pronat nën administrimin e saj të përkohshëm.

të fitojnë më shumë kohë për të vendosur nëse preferojnë ta mbajnë pronën apo jo, ndërsa në të njëjtën kohë ata u liruan nga presioni për ti shitur pronat e tyre ose nga rreziku i dëmtimit të mëtejshëm të pronave të tyre. Prandaj, administrimi i pronës ishte menduar vetëm si masë e përkohshme derisa kërkuesit kishin marrë vendimin përfundimtar (d.m.th. dëbimi) marrja në posedim e pronës së tyre, vendosja e pronës së tyre në skemë të qirasë dhe/ose nxjerrja e pronës në shitje përmes ankandit.⁷³ AKP-ja kishte të drejtë të mbante dhjetë për qind të shumës së qirasë për të mbuluar kostot administrative.

Skema e qiradhënies u zbatua në shumicën e komunave. Megjithatë, ka pasur edhe ca sfida. Për shembull, ndërsa zbatimi i skemës së qiradhënies në tërë Kosovën ishte i kënaqshëm, AKP-ja përballëj me probleme lidhur me zbatimin në komunat veriore. Siç është cekur në Raportin e IAP-së të vitit 2015,⁷⁴ një numër ankesash janë pranuar⁷⁵ nga pronarët në lidhje me mospagimin e qirasë nga qiramarrësit. Meqenëse AKP nuk ishte në gjendje t'i dëbonte ata, ata u bënë uzurpatorë.⁷⁶ Ekzekutimi i skemës së administrimit/qiradhënies u pengua veçanërisht në periudhën para nënshkrimit të Memorandumit me Policinë e Kosovës në vitin 2009, për shkak të hezitimit të policisë për të ndihmuar AKP-në në dëbimin e qiramarrësve që nuk arritën të paguajnë qiranë.

Sipas Raportit Final të KKP, 2,435 bartësit të së drejtës pronësore kishin zgjedhur të përfshijnë pronën e tyre në skemën e qiradhënies në qershor 2007, ndërsa skema ishte në dispozicion për të gjitha pronat nën administrim. Nga ana tjetër, në fazën përfundimtare të mandatit të AKP-së, në vitin 2016, në administrimin e tij kishte gjithsej 12.823 prona. Siç paraqitet në figurën 8 më poshtë, gjithsej 1,158 (9.03%) prona janë dhënë me qira, ndërsa 3,195 (24.92%) janë vlerësuar si të përshtatshme për qiradhënie. 8470 pronat e mbetura (66.05%) nuk ishin të përshtatshme për qiradhënie për shkak të vendndodhjes së tyre, kushteve të këqija ose mungesës së pëlqimit nga bartësit e së drejtës pronësore.

⁷³ Strategjia Nacionale e Kosovës për të Drejtat Pronësore, Ministria e Drejtësisë, dhjetor 2016, f. 31. Gjetet në http://krveministri-ks.net/repository/docs/National_Strategy_and_Annexes_ENG.pdf

⁷⁴ Intervista me përfaqësues të Institucionit të Avokatit të Popullit në Kosovë (Znj. Suzana Gashi), më 31 gusht 2018.

⁷⁵ Rastet A Nr. 48/2012 Xhevdet Kalludra; A Nr.176/2012 Mexhit Balija; A Nr.125/2013 Abdylqerim Mripa; A Nr. 36/2015 Hajrullah Bahtiri; A Nr.49/2015 Muhamed Sherifi kundër AKP, Raporti Vjetor i IAP (2015), f. 75.

⁷⁶ Sipas Ligjit për AKP-në, në qoftë se qiramarrësi do të ndalojë përmbushjen e detyrimeve të tij financiare për sa i përket qiradhënies, zyra përkatëse rajonale e AKP-së i dërgon urdhër dëbimi qiramarrësit duke e njoftuar atë; që brenda periudhës tridhjetë ditore ai/ajo është i detyruar ose të paguajë shumën e qirasë ose ta lirojë pronën. Në rast se nuk është bërë pagesa e qirasë dhe qiramarrësi nuk e ka liruar vullnetarisht pronën, zyra rajonale e KPA-së lëshon paralajmërim përfundimtar duke sqaruar se, nëse qiraja nuk paguhet brenda pesë ditëve, qiramarrësi është i detyruar të lirojë hapësirat. Në rast të kundërt, ata do të përballëshin me dëbimin. Për më shumë informacion, ju lutemi shikoni Raportin Vjetor të Agjencisë Kosovare e Pronës, të vitit 2009, Kapitulli 6, f. 23.

PRONAT NËN SKEMËN E ADMINISTRIMIT TË AKP-së (2006 - 2016)




Figura 8: Rastet e administruara nga AKP

Pas themelimit të AKKVP-së dhe në zbatim të nenit 21, paragrafi 7 i Ligjit për AKKVP, skemës së administrimit/qiradhënies i ishte dhënë fund. Ligji parashihte që administrimi i pronave të mbetura dhe zbatimi i skemës së qiradhënies të përfundojë jo më vonë se 18 muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Si rrjedhim, ky afat skadoi në maj 2018, dhe AKKVP "pezulloi"⁷⁷ funksionimin e këtij programi. Sipas Raportit Vjetor të fundit në dispozicion të AKKVP nga viti 2018, në skemën e qiradhënies vullnetare u përfshinë gjithsej 4,112 prona, ndërsa 8,342 prona u identifikuan si të papërshtatshme për t'u përfshirë në skemë për shkak të vendndodhjes së tyre, kushteve të dobëta ose për shkak të refuzimit të bartësve të së drejtës pronësore të japin pëlqimin e tyre për përfshirjen e pronave në skemë. Së fundmi, në fund të vitit 2018, gjithsej 4,112 prona janë përfshirë në skemën e qiradhënies vullnetare dhe 12,454 prona janë marrë nën administrimin e AKKVP.⁷⁸ Figura 9 më poshtë tregon luhatjen e numrit të pronave të përfshira në skemën e qiradhënies - në fund të mandatit të DÇPB-së, në kohën e mbylljes së AKP-së, si dhe deri në fund të 2018, sipas të dhënave aktualisht në dispozicion.

NUMRI I PËRGJITHSHËM I PRONAVE TË PËRFSHIRA NË SKEMËN E QIRASË




Figura 9: Rastet e skemës së qiradhënies

⁷⁷ Tabela e njoftimeve të AKKVP: <http://www.kpcva.org/Default.aspx>, e qasur më 20 nëntor 2019.

⁷⁸ Raporti Vjetor i AKKVP për vitin 2018, f. 128. Gjendet në http://www.kpcva.org/pdf/Raporti_2018.pdf, qasur më 19 nëntor 2019.

Skema e qiradhënies siguroi në mënyrë të arsyeshme mbrojtje ligjore dhe fizike për pronat banesore nën administrim dhe siguroi një burim minimal të ardhurash nga qiraja për bartësit e zhvendosur të të drejtave pronësore, të cilët ndryshe do të mund të ndjenin se nuk kanë mundësi tjetër pos asaj të shitjes së shtëpive të tyre. IAP nxori Rekomandim⁷⁹ për vazhdimin e këtij mjeti nga AKKVP, duke qenë se ndërprerja e papritur e skemës së administrimit pas skadimit të afatit prej 18 muajve do të rezultonte me implikime të rënda financiare për pronarët e pronave të paluajtshme nga komunitetet joshumicë dhe pronarët e zhvendosur të pronave të paluajtshme të cilët mbështeten në skemën e qirasë. Përveç kësaj, ekzistonte edhe rreziku konkret që do të mund të krijohet një boshllëk në lidhje me monitorimin dhe përcjelljen dhe mbajtjen e personave të zhvendosur të informuar. Për më tepër, afati kohor prej 18 muajve ka filluar të llogaritet që nga hyrja në fuqi të Ligjit për AKKVP, por masat e rëndësishme operative, të tilla si njoftimi për personat e zhvendosur, ende nuk janë krijuar. Kjo është arsyeja përse IAP konsideron se AKKVP nuk do të ishte në pozitë për ta përfunduar punën e vet për administrimin e pronave brenda afatit kohor prej 18 muajve. Rrjedhimisht, qeveria nisi ndryshimin e Ligjit që do të përcaktonte se AKKVP gëzon jo vetëm të drejtën që të kryejë dëbime të shumfishta (krahasuar me më së shumti dy dëbime që lejohen sipas ligjit në fuqi), siç përcaktohet në nënkapitullin 3.1 Uzurpimet e paligjshme dhe dëbimet të raportit, por edhe do të lejonte vazhdimin e administrimit të pronave për një periudhë të pacaktuar kohore.

Prandaj, kjo përbën një pengesë kryesore në lidhje me zbatimin e skemës së administrimit dhe qirasë nga AKKVP, duke qenë se vazhdimi i saj është e kushtëzuar ligjërisht me anë të ndryshimit të Ligjit të ri.

3.4 Rrënimi

Rrënimi është paraparë si instrument i ri për AKP dhe si mjet juridik për të siguruar ripozedimin e pronës së parashtruesit në rastet e ndërtimit të paligjshëm në tokën që kontestohet.⁸⁰ Është paraparë që të zbatohet në situatat kur ndërmjetësimi nuk do të rezultonte me zgjidhje të suksesshme të rastit. Megjithatë, jo shumë persona që kanë parashtruar kërkesa e kanë shfrytëzuar këtë mjet juridik duke qenë se kanë konsideruar se ajo vetëm sa e vonon procesin e kthimit të pronës. Të dhënat e nxjerra përmes raporteve vjetore të AKP-së dhe përmes intervistave me institucionet përkatëse, tregojnë se deri më tani nuk ka pasur ndonjë rast të rrënimit.⁸¹

⁷⁹ Raporti nr. 551/2017 i Institucionit të Avokatit të Popullit "Heqja e kompetencave të caktuara të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, sipas Ligjit Nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës", 2017. Në dispozicion në [https://oik-rks.org/wp-content/uploads/old_doc/ANG--_17-10-2017_Raporti_per_AKKVP\(1\)-1_922339.pdf](https://oik-rks.org/wp-content/uploads/old_doc/ANG--_17-10-2017_Raporti_per_AKKVP(1)-1_922339.pdf) qasur më 16 maj 2019.

⁸⁰ Ky mjet juridik nuk është paraparë nga DÇBP. Ju lutemi shihni Ligjin për ndryshimin e Rregullores nr. 2006/50 të UNMIK-ut për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale, 15 qershor 2008.

⁸¹ Ekziston rasti i mirënjohur i znj. Nadežda Jovanović, e cila ka paraqitur ankesë në IAP në lidhje me moszbatimin e Vendimit të AKP si dhe në lidhje me moszbatimin e vendimit gjegjës të Gjykatës Kushtetuese. Në përgjigjen e vet, IAP iu bë thirrje autoriteteve kompetente që të ndajnë mjete financiare për këtë qëllim, dhe u nxor raport për shkeljen e së drejtës në pronë, të drejtës për barazi para ligjit dhe për kohëzgjatjen për zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese më 25 mars 2015. Megjithatë, zbatimi i

Një nga argumentet e theksuara ishte se nuk kishte mjete të mjaftueshme financiare për ta zbatuar këtë instrument.⁸² Për shembull, ka pasur vendime⁸³ në të cilat KKKP kishte arsyetuar se parashtuesit i kërkesës iu njoh e drejta e posedimit të pronës së paluajtshme në të cilën ishte ndërtuar paligjshëm një shtëpi. Megjithatë, AKP pohonte se rrënimi në këtë fazë ishte i pamundur për shkak të mungesës së mjeteve financiare për ta angazhuar kompaninë e rrënimit dhe rrjedhimisht ka kërkuar mjete nga buxheti i Kosovës. Duke qenë se qeveria nuk dha përgjigje pozitive, AKP ofroi në vend të saj mjetin juridik të ndërmjetësimit, të cilin e refuzoi parashtuesi i kërkesës duke e paraqitur rastin në Gjykatën Kushtetuese në vitin 2014.⁸⁴ Përdorimi efektiv i rrënimit u pengua nga mungesa e mjeteve financiare e që e vonoi shumë procesin e kthimit të pronës.

Megjithatë, mjetet e pamjaftueshme financiare vështirë se mund të arsyetojnë moskryerjen e rrënimit duke qenë se ndërtimet e paligjshme paraqesin shkelje të qartë të drejtave pronësore të parashtuesit të kërkesës.⁸⁵ Për më tepër, vonesat në procesin e rikthimit të drejtave pronësore janë po ashtu subjekt i kritikave nga praktika gjyqësore e GJEDNJ. Për shembull, në rastin *Hornsby kundër Greqisë*⁸⁶ në mënyrë të qartë theksohet se zbatimi i një vendimi është pjesë integrale e së drejtës për gjykim të drejtë dhe se “mjeti efektiv juridik nuk duhet të mbetet vetëm në letër, por se edhe duhet të zbatohet në praktikë”. Përveç kësaj, Gjykata Kushtetuese e Kosovës po ashtu ka gjykuar se moszbatimi i vendimeve të KKKP nga AKP-ja dhe dështimi i autoriteteve kompetente për të siguruar mekanizma efikas për zbatimin e vendimeve të formës së prerë është në kundërshtim me parimet e sundimit të së drejtës dhe prandaj përbën shkelje të drejtave themelore të njeriut që garantohen me Kushtetutë.⁸⁷ Kjo paraqet jo vetëm vonesë të paarsyeshme në procedurë, por edhe

rekomandimeve ende nuk ka ndodhur. Përveç kësaj, IAP i ka rekomanduar AKP-së që të ndërmerr të gjitha masat për të siguruar zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese KI 187/13, të datës 16 prill 2014, me qëllim të mbrojtjes pa vonesë të mëtejme të së drejtës në pronë të znj. Jovanović.

⁸² Intervistë me përfaqësuesin e AKKVP.

⁸³ Për shembull: Shqyrtimi kushtetues në lidhje me moszbatimin e Vendimit GSK-KPA-A-001/12 të Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme, i datës 8 maj 2012, dhe të Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/A/114/2011, i datës 22 qershor 2011, Rasti nr. KI 187/13. Për më shumë informata, shih <http://gjk-ks.org/en/decision/constitutional-review-regarding-non-execution-of-the-decision-gsk-kpa-a-00112-of-the-appellate-panel-of-the-supreme-court-of-8-may-2012-and-of-the-decision-of-kosovo-property-claims-commission-no/>.

⁸⁴ Parashtuesja e kërkesës, znj. Jovanović, kundërshtoi moszbatimin e Vendimit GSK-AKP-001/12, të datës 8 maj 2012, të Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme dhe të Vendimit nr. KPCC/D/A/ 114/2011, të datës 22 qershor 2011, të Vendimit KKKP. Lënda e kësaj kërkesë ishte shqyrtimi kushtetues i moszbatimit të Vendimit GSK-AKP-001/12, të datës 8 maj 2012, të Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme dhe të Vendimit nr. KPCC/D/A/ 114/2011, të datës 22 qershor 2011, në rastin e parashtuesit nr. 16008 të paraqitur në Agjencinë Kosovare të Pronës më 23 gusht 2005. Për më shumë informata, shih: Rasti nr. KI187/13 i Gjykatës Kushtetuese (16 prill 2014, nr. i referencës.: AGJ 565/14) Shqyrtimi kushtetues i moszbatimit të Vendimit GSK-AKP-001/12, të datës 8 maj 2012, të Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme dhe të Vendimit i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/A/ 114/2011, të datës 22 qershor 2011. Në dispozicion në http://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjkk_ki_187_13_ang.pdf.

⁸⁵ Intervistë me përfaqësuesit e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës (Znj. Venera Kabashi, z. Sevdail Kastrati) më 7 gusht 2018, dhe me përfaqësuesin e Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian në Kosovë (Znj. Katarina Grbeša) më 1 gusht 2018.

⁸⁶ *Hornsby kundër Greqisë*, Kërkesa nr. 18357/91; ECHR 1997-II, 19 mars 1997, në dispozicion në <http://opil.ojplaw.com/view/10.1093/law:ihrl/3183echr04.case.1/law-ihrl-3183echr04#>.

⁸⁷ Rasti nr. KI187/13 i Gjykatës Kushtetuese (16 prill 2014, nr. i referencës.: AGJ 565/14) Shqyrtimi kushtetues i moszbatimit të Vendimit GSK-AKP-001/12, të datës 8 maj 2012, të Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme dhe të Vendimit i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/A/ 114/2011, të datës 22 qershor 2011. Në dispozicion në http://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjkk_ki_187_13_ang.pdf.

dështim të sistemit për të mbrojtur të drejtat e fituara që kanë të bëjnë me pronën dhe nuk mund të arsyetohen me mungesën e mjeteve financiare.

Vonesa në hartimin e Udhëzimit Administrativ (UA) të AKKVP për të rregulluar rregullat dhe procedurat e rrënimit paraqet edhe një pengesë tjetër për realizimin e të drejtave pronësore të palëve të prekura. Ndonëse kufizimet për shkak të burimeve të kufizuara do të mund të kuptoheshin, ekzistojnë obligime tjera me efekt të menjëhershëm, si miratimi i UA, që nuk kanë asnjë ndikim financiar. Prandaj, përfundimi i tij do të nënkuptonte jo vetëm hartimin e politikave e legjislacionit të nevojshëm për ushtrimin e përgjegjësisve të AKKVP kundrejt parashtresve të suksesshëm të kërkesave për rrënimin e ndërtimeve të paligjshme në pronat e tyre, por edhe do të demonstronte gatishmërinë e institucioneve dhe përkushtimin për të trajtuar rastet e tilla përkundër sfidave financiare me të cilat përballen. Duke pasur parasysh se rrënimi është paraparë tashmë si mjet juridik në vitin 2006, ngurrimi i AKP-ës për të nisur procesin e hartimit të UA-së gjegjëse e ka vonuar shumë fillimin e vënies në jetë të këtij mjeti, prandaj ka ndikuar drejtpërdrejtë në të drejtat pronësore të palëve të prekura.

Përfundimisht, në janar të vitit 2019, AKKVP përzgjedhi një kompani që do të zbatojë gjithsej 55 vendime për rrënimin e strukturave të ndërtuara paligjshëm në pronat e personave të zhvendosur. Megjithatë, drejtuesit e AKKVP shpjeguan se, për shkak të buxhetit të kufizuar që është ndarë për këtë qëllim (30.000 euro) nga qeveria, do të jetë e mundur që të rrënohen një apo dy ndërtime gjatë vitit 2019. Siç paraqitet në Ilustrimin numër 10, shumica e rrënimeve që duhet të kryhen janë në rajonin e Pejës (20), pasuar nga Prishtina (18), Gjilani (12) dhe Prizreni (5)⁸⁸.

RASTET E RRËNIMIT QË DUHET TË KRYHEN NGA AKKVP NË VITIN 2019




Figura 10: Rrënimet e planifikuara nga AKKVP

Prandaj, kryerja e rrënimeve në këto raste mbetet obligim i rëndësishëm që duhet të përmbushet me kohë nga AKKVP, jo vetëm për të siguruar se parashtresit e suksesshëm të kërkesave të kenë qasje në të drejtat e tyre pronësore, por edhe për shkak të ekzekutimit të vendimeve të formës së prerë në lidhje me kthimin e pronës si një tregues i efikasitetit të sundimit të së drejtës në një shoqëri demokratike. Në çdo rast, mungesa e UA-së për procedurat e rrënimit si dhe e mbështetjes financiare

⁸⁸ Informacioni u dha nga drejtuesit e AKKVP në maj të vitit 2019 dhe ishte ende i vlefshëm në gusht të vitit 2019.

kërkon veprim më të vendosur nga qeveria për ta trajtuar këtë çështje në mënyrë efektive.

3.5 Shqyrtimi paralel i rasteve nga gjykatat

Raporti mes mekanizmave dhe sistemit të gjykatave të rregullta të Kosovës gjithashtu përballet me probleme të caktuara, të cilat kryesisht kanë të bëjnë me vendime kontradiktore dhe rastet e moszbatimit të aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Siç u cek më sipër, vendimet e KKPB-së, ndonëse kanë karakter detyrues, nuk kanë përbërë zgjidhje përfundimtare të të gjitha çështjeve ligjore lidhur me konteste të caktuara pronësore. Pastaj, gjykatat ruajtën juridiksionin e tyre “për të gjykuar çfarëdo çështje ligjore që nuk është vendosur nga KKPB-ja,”⁸⁹ dhe mekanizmat bashkëpunuan rregullisht dhe i bartën rastet e caktuara tek ato. Kjo përfshiu kërkesat për çmimin e kontestuar të blerjes apo kompensimin e dëmit ose kërkesat dytësore të dorëzuara bashkë me kërkesën fillestare.

Në anën tjetër, mandatet e DÇBP, AKP dhe AKKVP u jepnin atyre juridiksion ekskluziv për kërkesat pronësore që kanë të bëjnë me konfliktin.⁹⁰ Në praktikë, kjo do të thotë se vendimet e nxjerra nga KKPB-ja iu ishin nënshkruar shqyrtimit vetëm nga Gjykata Supreme e Kosovës dhe jo nga gjykatat e rregullta, gjë që përbente përjashtim nga praktika standarde.⁹¹ Gjithsej 1293 (3.09%) ankesa u dorëzuan në Gjykatën Supreme të Kosovës nga gjithsej 41.849 vendime të KKPB-së.⁹² Rrjedhimisht, 210 ankesa u miratuan, ndërsa 663 raste të ankesave u hodhën poshtë dhe kështu vërtetuan vendimet fillestare të KKPB-së.⁹³ Sekretariatit Ekzekutiv më pas iu dha mandati që të zbatojë vendimet e apelit.

Sidoqoftë, edhe pse juridiksioni mes gjykatave të rregullta dhe mekanizmave të kërkesave në masë për zgjidhjen e kërkesave pronësore lidhur me konfliktin u përcaktua në mënyrë të qartë me anë të kornizës ligjore përkatëse, për shkak të mungesës së bashkërendimit, gjykatat e rregullta gjithashtu nisën procedurat për kërkesat e njëjta që në të vërtetë binin nën juridiksionin e AKP-së.⁹⁴ Kjo rezultoi me aktgjykime paralele që i la palët pa zgjidhje efektive të kërkesave të tyre. Ndonëse vendimet e AKP-së ishin të formës së prerë dhe aktgjykimet e gjykatave nuk kishin

⁸⁹ Rregullorja nr. 1999/23 e UNMIK-ut, neni 2.5, në dispozicion në <https://pca-cpa.org/wp-content/uploads/sites/6/2016/01/UNMIK-Regulation-1999-23.pdf>, qasur më 5 qershor 2019.

⁹⁰ Rregullorja nr. 2006/50 e UNMIK-ut, në dispozicion në http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/02english/E2006regs/RE2006_50.pdf, qasur më 1 korrik 2019.

⁹¹ Afati kohor për pranimin e kërkesave skadoi më 3 dhjetor 2007. Nga kjo datë, AKP nuk pranoi më kërkesa të reja (ndonëse vazhdoi me përpunimin e kërkesave në pritje), kurse të gjitha kërkesat pronësore që u dorëzuan pas dhjetorit të vitit 2007 ranë nën juridiksionin e gjykatave të Kosovës.

⁹² Numri i përgjithshëm i rasteve që u shqyrtuan nga AKP ishte 42749. Për më shumë informata, ju lutemi konsultoni raportin vjetor të AKKVP të vitit 2016, f. 149. Në dispozicion në: http://kpcva.org/pdf/Raporti_2016.pdf qasur më 12 shkurt 2020.

⁹³ Kjo informatë është deri më 31 dhjetor 2016.

⁹⁴ Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë, Sfidat në zgjidhjen e kërkesave pronësore lidhur me konfliktin në Kosovë, qershor 2011. Në dispozicion në <https://www.osce.org/kosovo/80435?download=true>, qasur më 1 korrik 2019.

efekt juridik për shkak të mungesës së kompetencës, shqyrtimi paralel i rasteve të AKP nga gjykatat e rregullta krijoi pasiguri juridike për parashtruesit e kërkesave. Kjo vonoi përfundimin e procesit për trajtimin e kërkesave.⁹⁵

Një aspekt tjetër i mandatit të AKP dhe AKKVP ka të bëjë me zbatimin e aktgjykimeve të nxjerra nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës, lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me skemat e kompensimit dhe strukturat e paligjshme. Megjithatë, pesë⁹⁶ vendime mbetën pa u zbatuar. Ndonëse Gjykata Kushtetuese kërkoi ekzekutimin e menjëhershëm të këtyre vendimeve, AKKVP pretendonte se, për shkak të mungesës së burimeve financiare dhe qartësisë ligjore, nuk është në gjendje që të vazhdojë me ekzekutimin e tyre.

Prandaj, jo vetëm moszbatimi i aktgjykimeve të nxjerra nga Gjykata Kushtetuese ka shkelur të drejtat pronësore të palëve të prekura, por edhe kërkesat konkurruese që janë paraqitur në DÇBP, AKP dhe gjykatat e rregullta kanë rezultuar në një metodë shumë të ndërlikuar dhe shpeshherë joefektive për mbrojtjen e të drejtave pronësore, duke qenë se aktgjykimet kontradiktore i lënë palët pa zgjidhje të vërtetë të kërkesave të tyre duke minuar kështu sundimin e së drejtës. Në anën tjetër, vonesat në emërimin e gjyqtarëve të Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme dhe të Komisionarëve në KKP, si dhe shpesh pozitat e lira për anëtarë nga bashkësia ndërkombëtare të Bordit Mbikëqyrës kanë ndikuar gjithashtu në punën e rregullt të mekanizmave.

3.6 Kërkesat e kategorisë A dhe C

Siç u cek në Hyrje, KKP kishte juridiksion ekskluziv posaçërisht lidhur me tre kategoritë e kërkesave për prona banesore që i referoheshin atij nga DÇBP - për të caktuar kompensimin monetar për kërkesat e caktuara të suksesshme nga kategoria A dhe C.⁹⁷ Kjo ka të bëjë me rastet ku të dy, parashtruesit njëri nga kategoria “A” e tjetri nga kategoria “C”, ishin parashtrues të suksesshëm të kërkesës për të njëjtën pronë. Sipas vendimeve të KKP, parashtruesit të kërkesës nga kategoria “A” iu dha e drejta mbi pronën, ndërsa kompensimi u vendos në dobi të palës tjetër (parashtruesit të kërkesës së kategorisë “C”).⁹⁸ Në fund të mandatit të DÇBP-së, në vitin 2006, rreth 258⁹⁹ kërkesa ishin në pritje të zbatimit.

⁹⁵ Intervistë me përfaqësuesit e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës (z. Sevdail Kastrati, Znj. Venera Kabashi) më 7 gusht 2018, dhe UNHCR (Znj. Milena Tasevska) më 2 gusht 2018.

⁹⁶ KI 132/15, KI 90/16, KI 65/15, KI 144/14 dhe KI 156/14, KI 187/13. Intervistë me përfaqësuesin e Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian në Kosovë (Znj. Katarina Grbeša), më 1 gusht 2018.

⁹⁷ Rregullorja nr. 1999/23 e UNMIK-ut, neni 1.2(a)-(c), në dispozicion në http://www.unmikonline.org/regulations/1999/re99_23.pdf, qasur më 18 qershor 2019.

⁹⁸ Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë, Departamenti i të Drejtave të Njeriut, Decentralizimit dhe Komuniteteve, Tetë vite më pas: Kthimi i minoriteteve dhe rikthimi i pronës banesore dhe pronës, qershor 2007, f. 27. Në dispozicion në <https://www.osce.org/kosovo/26322>.

⁹⁹ Raporti përfundimtar i vitit 2007, Komisioni për Kërkesa Banesore dhe Pronësore, Kapitulli 8 (Shërbimi dhe zbatimi i vendimeve të KKP), Të dhënat statistikore mbi zbatimin, f. 73. Në dispozicion në http://www.kpaonline.org/hpd/pdf/HPCC-Final_Report.pdf, qasur më 23 qershor 2019).

Në gusht të vitit 2005, u hartua legjislacioni i nevojshëm për ta zbatuar skemën e kompensimit. Miratimi i saj erdhi me nxjerrjen e Rregullores nr. 2006/50 të UNMIK-ut mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale në tetor të vitit 2006, që përcaktonte se skema e kompensimit do të zbatohet nën mbikëqyrjen e AKP të posa themeluar - neni 19 i Rregullores së UNMIK-ut përcaktonte se skema e kompensimit zbatohet “në pajtim me kriteret dhe procedurat e miratuara nga Agjencia Kosovare e Pronës për llogaritjen e shumave nga neni 4 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/60.”¹⁰⁰ Prandaj, AKP, dhe më vonë AKKVP, trashëguan përgjegjësinë për të zbatuar skemën e kompensimit për kërkesat e kategorisë A dhe C.

Sipas të dhënave nga viti 2016, Gjykata Kushtetuese ka nxjerrë tre¹⁰¹ aktgjykimeve ku ka konstatuar se moszbatimi i vendimit të KKBP lidhur me kompensimin është në kundërshtim me parimet e sundimit të së drejtës dhe se përbën shkelje të drejtave themelore të njeriut.¹⁰² Përderisa disa argumentonin se moszbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese ishte si pasojë e mungesës së financimit të mjaftueshëm,¹⁰³ të tjerët deklarorin se moszbatimi ishte jo vetëm në kundërshtim me sundimin e së drejtës, dhe se mungesa e mjeteve financiare nuk është arsyetim i vlefshëm për moszbatim.¹⁰⁴ Përveç kësaj, disa konsideronin se të dyja, AKP dhe Gjykata Kushtetuese, duhet të mbahen përgjegjëse duke qenë se Gjykata po ashtu dështoi që të veprojë përmes mjeteve në dispozicion të saj.¹⁰⁵ Për shembull, sipas Rregullores së Punës,¹⁰⁶ Gjykata Kushtetuese mund ta saktësojë mënyrën dhe afatin kohor për zbatimin e vendimit të Gjykatës. Sidoqoftë, në tre raste¹⁰⁷ Gjykata saktësoj afatin për zbatimin e vendimeve të saja, asnjëri prej të cilëve nuk u respektua. Përveç kësaj, sipas Rregullores së Punës, rregulli 66 përcakton dy masa që duhet të ndërmerren pas skadimit të afatit për zbatim: (1) Gjykata mund të lëshojë aktvendim në të cilin do të theksohet që vendimi nuk është zbatuar, e i cili publikohet në Gazetën Zyrtare, dhe/ose (2) Prokurori i Shtetit informohet për të gjitha vendimet e Gjykatës që nuk janë zbatuar.¹⁰⁸ Megjithatë, në rastet e lartcekura, nuk është shfrytëzuar asnjë nga këta mekanizma për ta trajtuar çështjen e moszbatimit të vendimeve.¹⁰⁹

¹⁰⁰ Shih nenin 19 të Rregullores nr. 1999/23 të UNMIK-ut. Në dispozicion në http://www.unmikonline.org/regulations/1999/re99_23.pdf, qasur më 1 korrik 2019.

¹⁰¹ Referencat e rasteve KI144/14, KI156/14 dhe KI187/13.

¹⁰² Raporti vjetor i AKKVP i vitit 2016, f. 164. Në dispozicion në http://www.kpaonline.org/PDFs/Raporti_2016.pdf, qasur më 1 korrik 2019.

¹⁰³ Intervistë me përfaqësuesit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (z. Besnik Ramosaj, z. Shkëlzen Maliqi), më 3 shtator 2018, dhe me Institucionin e Avokatit të Popullit (Znj. Suzana Gashi), më 31 gusht 2018. Institucioni i Avokatit të Popullit gjithashtu nxori një raport më 25 mars 2015, ku trajtohej çështja e shkeljes së të drejtave pronësore, të drejtës për barazi para ligjit dhe për kohëzgjatjen e procedurave për zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

¹⁰⁴ Intervistë me përfaqësuesit e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës (Znj. Venera Kabashi, z. Sevdail Kastrati) më 7 gusht 2018.

¹⁰⁵ Intervistë me përfaqësuesin e Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian në Kosovë (Znj. Katarina Grbeša), më 1 gusht 2018.

¹⁰⁶ Rregulli 63 i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese, 23 nëntor 2011 (e ndryshuar më 1 mars 2015), në dispozicion në http://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2017/11/gjkk_rregullore_e_punes_2015_ang.pdf

¹⁰⁷ Vilijamin Hajduković (KI 144/14) dhe Stanka Tuš (KI 156/14) - moszbatimi i vendimeve fillestare për 13, përkatësisht 2 vite; Ljubiša Marić (KI 65/15) - moszbatimi i vendimit fillestar për gati 5 vite; Nadežda Jovanović (KI 187/13) - moszbatimi i vendimit fillestar për më shumë se 7 vite.

¹⁰⁸ Rregullorja e Punës e Gjykatës Kushtetuese, në dispozicion në http://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2018/06/rregullore_e_punes_gjkk_ang_2018.pdf, qasur më 16 maj 2019.

¹⁰⁹ Intervistë me përfaqësuesin e Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian në Kosovë (Znj. Katarina Grbeša), më 1 gusht 2018.

Prandaj, shumica e nevojshme për këtë punë nuk u sigurua asnjëherë, dhe deri më tani zbatimi i skemës mbetet çështje e rëndësishme. Të dyja AKP dhe AKKVP kërkuan mbështetje financiare nga donatorët. Për shembull, gjatë rishikimit të buxhetit për vitin 2016, AKKVP i paraqiti kërkesë të gjithë donatorëve për ndarjen e 3.200,000 eurove. Mirëpo, vetëm qeveria i dha mbështetje duke ia ndarë 300.000 euro në vitin 2017,¹¹⁰ ndërsa 143 vendime për rastet e kategorive A dhe C¹¹¹ ende po presin që të zbatohen.

Figura 11 më poshtë paraqet ndarjen sipas rajoneve të rasteve të pazgjdhura në maj të vitit 2019.¹¹²

VENDNDODHJA E PRONAVE QË KANË TË BËJNË ME 143
VENDIME TË PAZBATUARA PËR KËRKESAT E KATEGORISË
A DHE C




Figura 11: Ndarja sipas rajoneve e kërkesave të kategorisë A dhe C

Arsye tjetër për zbatimin e mangët të skemës së kompensimit ka qenë mungesa e UA-së përkatëse, deri sa kjo e fundit u miratua nga qeveria në gusht të vitit 2018.¹¹³ Një gjë e tillë jo vetëm që ka shkaktuar vonesa të mëtejme në zgjidhjen e kërkesave pronësore të lidhura me konfliktin, por mosekzekutimi i vendimeve në lidhje me kërkesat e kategorisë A dhe C padyshim që ka përbërë shkelje serioze të së drejtës për mjete juridike efektive.

Kështu, gjendja e tanishme në lidhje me zbatimin e skemës së kompensimit mund të perceptohet jo vetëm si mungesë vendosmërie nga ana e AKP dhe AKKVP si autoritete kryesore përgjegjëse për t'u ofruar parashtruesve të kërkesave mjete juridike të drejta e efektive, porse edhe si mungesë fokusi nga ana e qeverisë në këto çështje si mënyrë e përmbushjes së detyrimeve të të drejtave të njeriut që burojnë

¹¹⁰ Qeveria ndau edhe 300.000 euro tjera në vitin 2018 dhe 600.000 euro në vitin 2019.

¹¹¹ Ky numër (258) paraqet numrin e parashtruesve të kërkesave. Në disa raste, ka pasur parashtrues të shumëfishtë të kërkesave për një pronë. Prandaj, ka pasur/janë gjithsej 143 prona.

¹¹² Të dhënat janë siguruar nga drejtuesit e AKKVP në maj të vitit 2019.

¹¹³ Udhëzimi Administrativ nr. 10/2018 për procedurat e skemës së kompensimit për zbatimin e vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore u miratuar në mbledhjen e 60-të të qeverisë së Kosovës, me Vendimin 01/60 të datës 7 gusht 2018, qasur më 1 korrik 2019.

nga e drejta ndërkombëtare dhe nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit¹¹⁴ (MSA) me Bashkimin Evropian (BE). Standardet ndërkombëtare parashohin mundësinë e kompensimit në rastet kur kthimi i pronës është i pamundshëm. Madje edhe GJEDNJ, përmes praktikës së vet gjyqësore (d.m.th. Doğan dhe të tjerë¹¹⁵), ka konstatuar se shtetet kanë për detyrë t'u sigurojnë personave të zhvendosur qasje të sigurt në pronën e tyre pavarësisht se a ka qenë vet shteti përgjegjës për krijimin e rrethanave që çuan në zhvendosje apo jo. Për më tepër, sipas aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese¹¹⁶ të përmendura në Kapitullin 3.5 të këtij raporti, “mosekzekutimi i vendimeve të KKP-së nga AKP-ja dhe dështimi i autoriteteve kompetente...për të siguruar mekanizma efektivë për sa i përket ekzekutimit të vendimeve të plotfuqishme, është në kundërshtim me parimin e shtetit të së drejtës...”¹¹⁷ Pra, është e qartë se për shkak të vonësive dhe moszbatimit të vendimeve në lidhje me kërkesat e kategorive A dhe C, parashtruesit e suksesshëm u privuan padrejtësisht nga të drejtat e tyre pronësore, e që u garantohen në mënyrë të qartë me nenin 46 të Kushtetutës¹¹⁸, ashtu si edhe me Nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së.¹¹⁹

Kështu, zbatimi i 143 vendimeve të nxjerra në lidhje me skemën e kompensimit të DÇPB vazhdon të jetë detyrim i rëndësishëm për AKKVP, duke qenë se mungesa e mekanizmave për zbatim nuk përbën arsye të mirëfilltë për t'u mohuar parashtruesve të drejtën për ta gëzuar pronën e tyre.

3.7 Sfidat e lidhura me financat dhe personelin

Mekanizmat përgjegjës për trajtimin e kthimit të pronave pas konfliktit në Kosovë janë përballur në mënyrë të vazhdueshme me sfida në kuptim të financimit e personelit. DÇPB-ja ka zhvilluar veprimtarinë e vet me afro 250 punonjës, gjersa struktura e personelit të AKP-së, në mbarim të mandatit të saj, kishte në përbërje një ekip të kombinuar¹²⁰ prej 243 punonjësve, prej të cilëve 2.43 për qind ishin staf ndërkombëtar në pozita drejtuese dhe 97.57 për qind punonjës vendorë me pozita nëpër njësi e dikasterë të ndryshëm të Agjencisë. Deri në fund të vitit 2018, AKKVP-ja kishte strukturë të ngjashme të personelit, ku veprimtarinë e vet e zhvillonte me 198 punonjës vendorë dhe një punonjës ndërkombëtar.¹²¹

¹¹⁴ Ligji nr. 05/L-069 për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Kosovës, në një të anë, dhe Bashkimin Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër, 1 dhjetor 2015. Gjetet tek: <https://qzk.rks-qov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=11240>.

¹¹⁵ GJEDNJ, Parashtrës nr. 8803/02, 8804/02, 8805/02, Aktgjykim i datës 29 qershor 2004. Gjetet në <https://www.osce.org/kosovo/80435?download=true>, qasur më 1 korrik 2019.

¹¹⁶ Gjykata Kushtetuese, Numrat referencë të rasteve KI144/14, KI156/14 dhe KI187/13.

¹¹⁷ Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese në rastet nr. KI144/14, KI156/14, Vlerësim i kushtetutshmërisë së mospërmbarimit të dy vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banësore, përkatësisht Vendimit nr. HPCC/REC/91/2007, të 19 janarit 2007, dhe Vendimit nr. HPCC/REC/81/2006, të 11 dhjetorit 2006, 4 gusht 2015. Gjetet tek http://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjk_ki_144_14_156_14_ang.pdf, qasur më 19 maj 2019.

¹¹⁸ Neni 46 (Mbrojtja e pronës), Kushtetuta e Kosovës, 15 qershor 2008. Gjetet në <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Constitution1Kosovo.pdf>, qasur më 1 korrik 2019.

¹¹⁹ Neni 1, Protokollit 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në dispozicion tek <http://echr-online.info/right-to-property-article-1-of-protocol-1-to-the-echr/introduction/>.

¹²⁰ Kapitulli 4.6.1. “Pasqyra e punonjësve të Agjencisë” nga Raporti vjetor i AKKVP për vitin 2016, f. 138. Gjetet në http://www.kpaonline.org/PDFs/Raporti_2016.pdf, qasur më 1 korrik 2019.

¹²¹ Sipas të dhënave të ofruara nga menaxhmenti i AKKVP-së në maj të vitit 2019.

Financimi i DÇPB-së gjatë gjithë periudhës së funksionimit të saj ishte i mangët dhe është siguruar përmes kontributit të donatorëve. Statistikat tregojnë se kostoja totale e procesit DÇPB/KKPB e akumuluar përgjatë viteve kapte shifrën prej 26.2 milion dollarësh, ku nga kjo shumë shpenzimet operationale përbënin afërsisht 30 për qind të buxhetit të gjithmbarshëm, gjersa pjesa e mbetur prej 70 për qind shpenzohej për paga.¹²²

Nga ana tjetër, ndonëse e mbështetur financiarisht nga buxheti i Kosovës dhe një numër aktorësh ndërkombëtarë,¹²³ edhe AKP-ja është përballur vazhdimisht me vështirësi në sigurimin e stabilitet financiar qysh nga themelimi. Porse, Agjencia i ka drejtuar për çdo vit letra gjithë donatorëve e qeverisë duke kërkuar mjete shtesë për mbulimin e kostos së krijuar nga skema e kompensimit dhe rrënimi i ndërtimeve pa leje. Megjithatë, financimi nga qeveria ka arritur t'i mbulojë nevojat financiare të AKP-së vetëm në mënyrë të pjesshme, për nevoja të tilla sikundër pagat e punonjësve, por nuk ka qenë i mjaftueshëm për të mbuluar kostot operationale.¹²⁴ Në vitin 2016, 92.54 për qind e buxhetit të AKP-së është siguruar nga buxheti i konsoliduar i Kosovës, ndërsa 7.46 për qind nga donatorë ndërkombëtarë. Siç ilustron në tabelën më poshtë, buxheti i gjithmbarshëm i Agjencisë për vitin 2016 ishte 1,883,101 EUR, gjersa kostot vjetore vlerësohet të kenë qenë 3,435,952 EUR.¹²⁵

2016	KOSTOT MUJORE	KOSTOT VJETORE	BUXHETI I RISHIKUAR	TË ZOTUARA
Gjithsej buxheti i AKP në EUR	286,330	3,435,952	1,883,101	1,883,101

Tabela 1: Buxheti i AKP për vitin 2016

Më konkretisht, mjetet financiare të siguruar nga buxheti i konsoliduar i Kosovës në shumë prej 1,742,697 EUR u ndanë në mënyrën në vijim: Paga dhe Mëditje (1,175,404 EUR), Mallra dhe Shërbime (468,965 EUR), Shërbime Komunale (79,718 EUR), si dhe Shpenzime Kapitale (18,611 EUR). Ndërkaq, prej gjithsej 140,403 EUR të siguruar nga donatorë ndërkombëtarë, 99,795 EUR janë ndarë për Paga dhe Mëditje, gjersa 99,795 EUR janë ndarë për Mallra dhe Shërbime.

¹²² Margaret Cordial, Knut Rösandhaug, Kthimi i pronës; situara pas konfliktit: (2 Vellime): Qasja e Kosovës dhe mësimet e mësuara për praktikën ndërkombëtare në të ardhmen (Martinus Nijhoff Publishers, 1 shtator 2009), f. 191–193.

¹²³ Belgjika, Gjermania, Norvegjia, Suedia, Zvicra, Mbretëria e Bashkuar, SHBA dhe BE.

¹²⁴ Intervistë me përfaqësuesen e Përfaqësuesit të Posaçëm të Bashkimit Evropian në Kosovë (znj. Katarina Grbeša) e realizuar më 1 gusht 2018.

¹²⁵ Shih Raportin vjetor të Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2016, Kreu XI, f. 177–179. Gjetet në http://www.kpaonline.org/PDFs/Raporti_2016.pdf, qasur më 1 korrik 2019.

BURIMET E BUXHETIT TË AKP 2016




Figure 12: KPA budget source in 2016

Një gjë e tillë, krahas faktit që Agjencia nuk ishte mirëfilli funksionale për një periudhë të caktuar kohore për shkaqe të tjera politike, sipas argumenteve të paraqitura nga menaxhmenti i lartë i ka pamundësuar Agjencisë që t'i mbajë punonjësit që ishin më të kualifikuar.¹²⁶ Si rrjedhojë, disa ekspertë të fushës së kadastrit dhe të drejtave pronësore, bashkë me profesionistë të fushës së gjeodezisë, dhanë dorëheqje nga detyrat e tyre.¹²⁷

Për më tepër, kërkesat e AKKVP për mbështetje financiare shtesë drejtuar qeverisë dhe donatorëve ndërkombëtarë rezultuan të pasuksesshme. Duke marrë parasysh detyrat e papërfunduara të trashëguara nga paraardhësi i saj, veçanërisht zbatimin e 143 vendimeve sipas nenit 4 të Rregullores 2000/60 të UNMIK-ut në lidhje me skemën e kompensimit të DÇBP-së, mungesa e mjeteve financiare vazhdon të jetë pengesë brengosëse për AKKVP-në. Në kohën e hartimit të këtij raporti, AKKVP-ja vazhdon të përballet me vështirësi për të siguruar shumën e nevojshme për kryerjen e pagesave të duhura për kompensim. Nevojat financiare për vitin 2018, sipas përlogaritjeve të vet agjencisë, kanë kapur shumën prej 5,900,395 EUR¹²⁸. Nuk ka financim të rregullt nga donatorët, ndërsa shuma prej 2,729,373 EUR¹²⁹ i është ndarë nga Buxheti i Kosovës për vitin 2018.¹³⁰ Kësisoj, në fund të vitit 2018, AKKVP-ja kishte një normë realizimi prej 96 për qind, duke qenë se buxheti përfundimtar i shpenzuar arriti shumën prej 2,611,936 EUR dhe u shpenzua sipas tabelës së paraqitur më poshtë.

¹²⁶ Kreu 6.12 "Qëndrueshmëria financiare" nga Raporti vjetor i AKKVP-së për vitin 2016, f. 163. Gjetet në http://www.kpaonline.org/PDFs/Raporti_2016.pdf, qasur më 1 korrik 2019.

¹²⁷ Intervistë me përfaqësuesen e AKKVP (znj. Florije Kika) e realizuar më 3 gusht 2018.

¹²⁸ Rrjedhimisht, vlera e deficitit për vitin 2018 ishte 2,994,663 EUR. Shih Agjencia Kosova për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, Raport vjetor 2018, Shtojca B dhe C, f. 150.

¹²⁹ Sipas të dhënave të ofruara nga menaxhmenti i AKKVP-së në maj të vitit 2019.

¹³⁰ Ligji nr. 05/L-125 për buxhetin e vitit 2017. Gjetet tek <https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-125%20a.pdf>, qasur më 3 qershor 2019.

REALIZIMI I BUXHETIT TË AKKVP NË EUR

1. Paga dhe mëditje	1,121,421
2. Mallra dhe shërbime	1,163,645
3. Shërbime komunale	75,633
4. Investime Kapitale	368,673
Gjithsej	2,729,373

Tabela 2: Buxheti i AKKVP për vitin 2018

Veç kësaj, vonesat në miratimin e plotësim-ndryshimeve të Ligjit për AKKVP-në¹³¹ kanë çuar në sfida serioze për personelin e AKP-së, duke qenë se kanë shpërfaqur pasiguri sa i përket qëndrueshmërisë së këtij institucioni. Gjatë vitit të fundit të funksionimit të AKP-së, Agjencia nuk arriti të emëronte me kohë dy anëtarë vendorë të Bordit dhe menaxhmentin e lartë, përfshirë këtu drejtorin e zëvendës-drejtorin.¹³² E gjithë kjo ka pasur ndikim në funksionimin e gjithëmbarshtëm të AKP-së, ndërsa humbja e kuadrove kyçe ka vazhduar të jetë sfidë për AKKVP-në duke ngadalësuar dhe më tej procesin e përgatitjes së një plani përmbajtësor si edhe strategjive financiare dhe dalëse.

Kështu, paqëndrueshmëria financiare ka ndikuar shumë në punën e institucioneve përgjegjëse për trajtimin e kthimit të pronave pas konfliktit, meqë e ka penguar funksionimin e tyre dhe ka çuar në humbje të kuadrove të kualifikuara. Sidoqoftë, pengesat financiare, qoftë edhe të justifikueshme, nuk do duhej që në asnjë rrethanë të jenë barrë mbi supet e pronarëve të ligjshëm të pronave dhe të ndikojnë në qasjen e tyre në të drejtat pronësore. Duke marrë parasysh që përgjegjësitë e mekanizmave janë të përcaktuara qartë, është më se e dukshme se asnjëri nga ta nuk ka arritur ta realizojë mandatin përkatës në mënyrë të plotë, posaçërisht kur është fjala për skemën e kompensimit dhe rrënimet. Për më tepër, po të shikohen buxheti vjetor dhe realizimi i tij, duket të ketë një disbalanc ndërmjet numrit të punonjësve dhe nevojave financiare të lidhura me funksionimin e mekanizmit. Për shembull, shpenzimet vjetore të mekanizmit për pagat e punonjësve kapin shifrën prej 1.12 milion EUR, derisa shuma e nevojshme për ta lehtësuar zbatimin e skemës së kompensimit në tërësi sillet diku rreth 1.5 milion EUR. Kjo sjellë në shprehje pikëpyetjen se a ka vërtet nevojë për një mekanizëm i cili është në gjendje t'i mbulojë vetëm shpenzimet e pagave të punonjësve, kur një gjë e tillë nënkupton pamundësi për të siguruar qëndrueshmëri financiare për veprimtarinë e vet kryesore.

¹³¹ Ligji nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP). Gjetet tek http://www.kpaonline.org/framworkPDFs/English/LAW_NO.05_L-010_ON_KOSOVO_PROPERTY_COMPARISON_AND_VERIFICATON_AGENCY.pdf, qasur më 6 maj 2019.

¹³² Kreu 6.14 "Vonesa në miratimin e Ligjit për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës" i Raportit vjetor të AKKVP-së për vitin 2016, f. 164. Gjetet tek http://www.kpaonline.org/PDFs/Raporti_2016.pdf, qasur më 1 korrik 2019.

4. PËRFUNDIM

Gjatë njëzet vjetëve të punës së mekanizmave për kërkesa pronësore të lidhura me konfliktin në Kosovë¹³³, janë zgjidhur më shumë se 70,000 kërkesa për prona banesore, komerciale e bujqësore. Ky numër flet jo vetëm për vëllimin e punës por njëherazi konfirmon statusin e tyre si mjetin më të rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave pronësore të komuniteteve joshumicë dhe personave të zhvendosur. Mekanizmat kanë pasur kompetenca ekskluzive për shqyrtim dhe vendosje të këtyre rasteve, duke shërbyer si ndërmjetës midis palëve dhe duke kontribuar në parandalimin e konflikteve.

Megjithatë, këta mekanizma janë përballur me sfida të mëdha në kuptim të realizimit të mandatit të tyre. Mungesa e mjeteve financiare të mjaftueshme ka vazhduar së qenuri pengesë kryesore, për shembull, duke ua rënduar shumë punën me zbatimin e skemës së kompensimit për kërkesat e kategorisë A dhe C, si dhe rrënimin e ndërtimeve pa leje në pronat e personave të zhvendosur. Veç kësaj, mangësi vazhdon të ketë edhe në kuptim të bashkërendimit e bashkëpunimit efektiv midis institucioneve të Kosovës, përfshirë këtu gjykatat. Ka vonesa në emërimet e gjyqtarëve në Kolegjin e Apelit në kuadër të Gjykatës Supreme dhe të komisionerëve në Komisionin për Kërkesave Pronësore; kohë-pas-kohe ndikim në efektshmërinë e zgjidhjes së kërkesave nga ana e këtyre mekanizmave kanë pasur edhe pozitat e zbrazëta në Bordin Mbikëqyrës nga radhët e bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë. Në bosht të problemit qëndrojnë mangësitë në zbatimin adekuat të legjislacionit. Një nga shembujt, siç është shtjelluar më herët në këtë raport, ka qenë pamundësia ligjore për ta ekzekutuar dëbimin më shumë se dy herë, derisa rastet e uzurpimit të paligjshëm ishin të shumta.

Gjithashtu, ndërsa zbatimi i kërkesave për rrënim të ndërtimeve pa leje ishte peng i vështirësive financiare, mekanizmat janë vonuar në hartimin e akteve ligjore që do të siguronin bazën dhe hollësitat tjera për zbatim të këtyre rrënimeve me rastin e disponueshmërisë së mjeteve financiare për ta bërë një gjë të tillë. Gjithë kjo ka kontribuar përfundimisht në vonesa në zgjidhjen e kërkesave pronësore, e që kanë prekur jo vetëm punën e mekanizmave por madje shpesh kanë bërë që për kërkesat e palëve të mos ketë mjete juridike të shpejta e efektive.

¹³³ Drejtoria për Çështje Banesore dhe Pronësore, Agjencia Kosovare e Pronës, dhe Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.

Duke e pasur parasysh faktin se AKKVP-ja nuk ka qenë në gjendje t'i ushtrojë përgjegjësitë e përcaktuara me mandatin e vet për gati tre vjet që nga themelimi, një pyetje që vjen shpesh në shprehje është nëse ka vërtet nevojë për agjenci të këtillë pasi të jenë zbatuar të gjitha raste e DÇPB dhe AKP.

Sidoqoftë, sigurimi i mjeteve juridike të drejta dhe legjitime për të gjitha palët, të drejtat pronësore të të cilave janë prekur, duhet të mbetet prioritet, ndërsa institucionet e Kosovës duhet të ofrojnë mbështetje të fortë në trajtimin e kësaj çështje. Po të shikohet mandati kryesor i AKKVP-së më për së afërmi, del që kjo Agjenci ka për detyrë të bëjë krahasimin dhe verifikimin e librave të kadastrit që Beogradi është dashur t'ia dorëzojë Prishtinës. Fatkeqësisht, deri në momentin e hartimit të këtij raporti,¹³⁴ kjo gjë nuk ka ndodhur.¹³⁵ Natyrisht, nëse palët nuk përkushtohen seriozisht që t'i përmbahen Marrëveshjes për Kadastrin të arritur në Bruksel në vitin 2011, çështja duhet të adresohet më tej nga qeveria e Kosovës në konsultim me Bashkimin Evropian.

Në fund, meqë kthimi i pronave të humbura si rrjedhojë e konfliktit është ndërhyrje me prioritet për fuqizimin dhe garantimin e të drejtave pronësore të komuniteteve joshumicë, është e një rëndësie parësore që AKKVP-ja të vazhdojë së adresuari këtë çështje. Mirëpo, kjo duhet të bëhet në kohë dhe në mënyrë efektive. Derisa institucionet vendore duhet të ndajnë mjete të mjaftueshme nga buxheti i Kosovës, akterët ndërkombëtarë duhet të mbështesin fuqimisht AKKVP-në në jetësimin e gjithë detyrave dhe përgjegjësi të saj. Kështu, duke ditur që të drejtat pronësore të palëve të prekura mund të sigurohen vetëm nëpërmjet një mekanizmi që funksionon në mënyrë të mirëfilltë, është e domosdoshme që puna e AKKVP-së të zë vend kryesor në agjendat e institucioneve përkatëse vendore dhe bashkësisë ndërkombëtare të pranishme në Kosovë deri sa të jenë përfunduar të gjitha rastet e DÇPB-së dhe AKP-së.

¹³⁴ Dhjetor 2019.

¹³⁵ Ka mospajtime ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit për sa i përket asaj se nga kush dhe në ç' mënyrë duhet të shqyrtohen librat e kadastrit. Marrëveshja e lidhur nga palët, në nenin 2 parasheh formimin e një grupi trepalësh në përbërje të ekspertëve nga të dyja vendet dhe nën kryesimin e BE që të monitorojë punën e një agjencie teknike. Agjencia e themeluar nga qeveria e Kosovës me Ligjin nr. 05/L-010 nuk parasheh të ngrisë asnjë grup trepalësh siç thuhet në marrëveshje. Megjithatë, bordi i drejtorëve të Agjencisë përbëhet nga tre anëtarë ndërkombëtarë të kryesuar nga BE.

MEKANIZMI I SHQYRTIMIT TË KËRKESAVE NË MASË PËR TË DREJTAT PRONËSORE: Përvoja e Kosovës

Qershor 2020